


UNIVERZITETI I EJL Fakulteti Juridik

ЈИЕ УНИВЕРЗИТЕТ Правен Факултет

SEE UNIVERSITY Faculty of Law



**STUDIME PASDIPLOMIKE - CIKLI I DYTË
PROGRAMI-E DREJTA CIVILE**

TEZA:

**“SHKURORËZIMI I MARTESËS DHE KUJDESTARIA E FËMIJËVE
NË PRAKTIKËN GJYGJËSORE NË RAJONIN E DIBRËS NË
PERIUDHËN KOHORE 2007-2017”**

Kandidati :

Rudina Cami

Mentori :

Prof. Dr.Emine Zendeli

Tetovë, 2019

“Shkurorëzimi është pranimi i dështimit, ashtu si martesë”

Roberto Gervaso

FALENDERIM

Përgatitja dhe finalizimi i këtij projekti kaq të rëndësishëm në jetën profesionale dhe akademike ka gjetur mbështetjen, përkahjen dhe dashamirësinë e shumë personave të rëndësishëm në jetën time, të cilët gjej rastin t'i falenderoj për zemërsisht. Falënderim për udhëheqësen shkencore, Prof. Dr. Emine Zendeli, për ndihmën që më ka dhënë gjatë strukturimit dhe shkrimit të temës. Mirënjohje dhe falënderim për mbështetjen profesionale, akademike, psikologjike dhe shpirtërore në hartimin dhe përfundimin e këtij punimi.

Contents

FALENDERIM.....	3
ABSTRAKT	7
ABSTRACT (ENGLISH LANGUAGE).....	8
HYRJE	9
METODOLOGJIA E HULUMTIMIT	Error! Bookmark not defined.
KAPITULLI I PARË KUPTIMI I SHKURORËZIMIT TË MARTESËS.....	11
1. Shkurorëzimi si institucion.....	12
1.1. Zhvillimi historik i shkurorëzimit.....	15
1.2. E drejta e shkurorëzimit sipas Ligjit për Familje të RM-së.....	17
1.2.1. Procedura e shkurorëzimit.....	19
1.2.2. Zhvillimi i procedurës së shkurorëzimit.....	21
1.3. Format e inicimit të procedurës së shkurorëzimit të martesës.....	22
1.3.1. Shkurorëzimi i martesës në bazë të marrëveshjes reciproke të bashkëshortëve.....	23
1.3.2. Shkurorëzimi i martesës me kërkesë të njërit bashkëshort.....	25
1.4. Subjektet që kanë të drejtë në padi për shkurorëzim.....	26
1.5. Seanca për pajtimin e bashkëshortëve.....	28
1.6. Shqyrtimi kryesor.....	32
1.7. Marrja e aktgjykimit.....	32
1.8. Pasojat e shkurorëzimit të martesës.....	33
KAPITULLI I DYTË TUTORIA DHE KUJDESTARIA E FËMIJËVE PAS SHKURORËZIMIT.....	38
1. Kuptimi i së drejtës së kujdestarisë.....	38
2. Të drejtat prindërore dhe kujdestaria	41
a) Kujdestaria e fëmijës në rast shkurorëzimi	43
KAPITULLI I TRETË METODOLOGJIA.....	45
1. Statistikat e lidhjeve të martesës dhe shkurorëzimet në RM gjatë vitit 2016.....	48
Tabela.Shkurorëzimet në bazë të muajve.....	479

Sa është numri i rasteve ku Gjykata ka vendosur që kujdestarinë e fëmijëve t'ia lejoj njërit nga prindërve përgjatë periudhës 10 vjeçare në Praktikën Gjyqësore në Dibrë?	48
Sa është numri i rasteve për shkurorëzimet në të cilat është vendosur që kujdestaria e fëmijëve tu jepet prindërve?	49
Numri i Rasteve të shkurorëzimeve të sjellura nga ana e Gjykatës – në bazë të marrëveshjes për kujdestarinë e fëmijëve nga ana e njërit prind.	49
Numri i Rasteve të shkurorëzimeve të sjellura nga ana e Gjykatës – në bazë të padisë nga ana e njërit prind.	50
Sa është numri i rasteve (lëndëve) ku Gjykata e Rajonit të Dibrës i aka dorëzuar fëmijët nënës / babait?	50
Në sa raste me kërkesë nga Gjykata, ka marrë pjesë ekipi i qendrës sociale për mbrojtjen e fëmijëve? 50	
REZULTATET E HULUMTIMIT	51
1.1. Anketa	51
Rezultatet e hulumtimit janë të paraqitura në tabela dhe grafikone	54
Tabela 1.....	54
Grafikoni 1.....	54
Tabela 2.....	54
Grafikoni 2.....	55
Tabela 3.....	55
Grafikoni 3.....	56
Tabela 4.....	56
Grafikoni 4.....	56
5. A jeni aktualisht e martuar ose bashkëjetoni me një burrë/ grua?	57
Tabela 5.....	57
Grafikoni 5.....	57
6. Cili është statusi juaj martesor?	58
Tabela 6.....	58
Grafikoni 6.....	58
7. Cila është arsyeja kryesore e shkurorëzimit në rajonin e Dibrës?.....	59
Tabela 7.....	59
Grafiku 7.....	59
8. Kur çiftet vendosin që të ndahen, si e konsiderojnë çështjen e fëmijëve?	62
Tabela 8.....	62

Grafiku 8.....	62
9. Kush më së shumti vuan pas shkurorëzimit?	63
Tabela 9.....	63
Grafiku 9.....	63
10.Çfar efekti ka shkurorëzimi tek fëmijët?.....	63
Tabela 10.....	63
Grafiku 10.....	64
11. Bashkëshorti juaj, a u ndihmon financiarisht me të holla për fëmijën?	64
Tabela 11.....	64
Grafiku 11.....	65
12.A ka ndodhur ndonjë rast, kur bashkëshorti juaj u ka kërcnuar juve, ose fëmijëve tuaj për dëmtim. 65	
Tabela 12.....	65
Grafiku 12.....	66
13.A jeni shqetësuar për e sigurinë tuaj fizike ose sigurinë e fëmijëve?	66
Tabela 13.....	66
Grafiku 13.....	67
14. Përzgjedhjen e kujdestarisë kush e realizon?	67
Tabela 14.....	67
Grafiku 14.....	68
KAPITULLI I KATËRT PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME.....	70
1. Përfundimi.....	71
Biblografia	723
Akte ligjore, Konventa, Direktiva.....	734
Burime nga interneti	734

ABSTRAKT

Temën të cilën e kam përzgjedhur që ta trajtoj i takon fushës civile, respektivisht të drejtës familjare dhe trajtohet pikërisht shkurorëzimi dhe kujdestaria e fëmijëve në praktikën gjyqësore të Gjykatës së Dibrës për një dekadë vitesh (2007-2017). Në suaza të këtij punimi do të analizohen të dhënat statistikore mbi numrin e shkurorëzimeve dhe faktorëve që ndikojnë në tek shkatërimin e martesës në rajonin e qytetit të Dibrës. Shkurorëzimi mbetet një ndër faktorët që ndikon shumë negativisht në rritjen dhe mirrëritjen e fëmijëve dhe në zhvillimin e shoqërive. Kam përzgjedhur pikërisht këtë temë duke pasur parasysh faktin se dita ditës ndeshemi më probleme që burojnë nga shkurorëzimi i martesës ndërsa fëmijët janë viktimat kryesore të tij. Gjithashtu si synim në punim tim është që të gjej përgjigje lidhur me pyetjen se: *A është martesa jonë në pikë kritike?*

Mbase bashkëshorti ka tradhëtuar besimin tënd ose konfliktet e vazhdueshme kanë shterur gëzimin e lidhjes suaj. Përpara se të marrim një vendim të nxituar për t'i dhënë fund martesës, duhet që të mendohemi mire. Shkurorëzimi nuk është zgjidhje as ilaçi për ankthet e jetës. Përkundrazi, shpes ai vetëm sa mbyll disa problem hap disa të tjera. Duke u udhëhequr nga një situatë e cila mbretëron në shoqërinë tonë hulumtimi im do të përfshijë analizën e detajizuar të kornizës ligjore e cila është rregulluar me dispozitat e Ligjit mbi familje të Republikës së Maqedonisë. Në këtë studim do të mundohem që të paraqes dhe të shpejtoj rëndësinë e kujdestarisë si faktor shumë i rëndësishëm.

ABSTRACT (ENGLISH LANGUAGE)

The theme that I have choosed to deal belongs in civil field and it is precisely the divorce and custody of children in Debar's jurisprudence for decade (2007-2017). Whitin this work, statistics will be revieēed in the region of Dibra ēith the number of Divorces and factors that affecting in the destruction of marriage. Divorce remains one of the factors that greatly affect the development of children and societies. The consequences of solving marriage are mostly the children. I have chosen this topic, given the fact that day by day we are faced with marital problems and children are the ones who fall victim to. Also my point on my paper is the point: is our marriage at a critical point?

Perhaps your spouse has betrayed your faith or the controversial conflicts have exhausted the joy of your attachment. Before you make a rash decision to end marriage, we need to think well. Divorce is not a solution or a cure for life's anxieties. Rather, he just closes some problems and opens up some others. Guided by a situation that reigns in our society, my research ēill include a detailed analysis of the legal frameēork that is regulated by the provisions of the Family Law of the Republic of Macedonia. In the study I will try to present and speed up the importance of guardianship as a very important factor.

HYRJE

Mbi temën e titulluar, “Shkurorëzimi i martesës dhe kujdestaria e fëmijëve në praktikën gjyqësore në rajonin e gjykatës së Dibrës në periudhën kohore 2007-2017”, do të mundohem që të sqaroj institutin e shkurorëzimit i cili paraqetnjë të drejtë të njeriut. Ai është një shprehje e lirisë së individit për të dashuruar dhe për të zgjedhur.

Sipas dispozitave të Ligjit për familje të Republikës së Maqedonisë martesë, duhet të bazohet në dashurinë, barazinë, respektin, dhe ndihmën reciproke midis bashkëshortëve, mirëpo në rast të disbalansit dhe mosrespektimit të këtyre parimeve jeta bashkëshortore bëhet e padurueshme ashtu që pamundësohet vazhdimin i mëtutjeshëm i saj. Si pasojë e problemeve të papërballueshme të cilat i përkasin martesës së tyre, bashkëshortët, duke pasur të drejtën e vendimmarrjes së përbashkët i japin fund asaj me anë të institucionit të shkurorëzimit, nën kushtet dhe sipas një procedure të caktuar me ligj.

Shkurorëzimi është problem sa juridik aq edhe social, dhe kryesisht shkaktohet, kur ndërmjet bashkëshortëve nuk ekziston më dashuria, respekti, komunikimi dhe padyshim se marrëdhënia e tillë nuk funksionon më, ashtu që si pasojë e gjithë kësaj vjen deri tek shkurorëzimi, i cili shkakton një stres të përgjithshëm tek të gjithë anëtarët e familjes e sidomos tek fëmijët.

Objekt i studimit në punimintim është shkurorëzimi dhe kujdestaria e fëmijëve në Praktikën Gjyqësore në Rajonin e Dibrës për një periudhë të caktuar kohore. Legjislacioni i vendit dhe ai ndërkombëtar e rregullojnë dhe garantojnë këtë tematikë dhe raportet shoqërore që lidhen me të.

KAPITULLI I PARË
KUPTIMI I SHKURORËZIMIT TË MARTESËS

1. Shkurorëzimi si institucion

Martesa është institucion i rëndësishëm shoqëror dhe juridik, dhe paraqet marrëdhënie të jetës së përbashkët e të vazhdueshme midis një burri dhe një gruaje, ndërkaq në disa shtete edhe marrëdhënie midis dy personave me gjini të njëjtë (në shtete të cilët me legjislacionet e tyre e kanë të legalizuar martesën midis personave me gjini të njëjtë)¹. Martesa është marrëdhënie e vazhdueshme, por jo e prëhershëm andaj cdo martesë e lidhur edhe mund të zgjidhet në bazë të disa fakteve apo rrethanave që i ka paraparë ligji. Martesa pushon me vdekjen e njërit prej bashkeshortëve, me shpalljen e bashkëshortit të zhdukur për të vdekur, me anulim dhe me shkurorëzim të martesës.²

Shkurorëzimi është institucion i lashtë mund të themi se është pjesë e pandashme e martesës. Është dukuri e së drejtës familjare i cili mundëson zgjidhjen e martesës së plotëfuqishme, mund të përkufizohet si zgjidhje *es nunc* e martesës së plotëfuqishme, gjatë jetës së bashkëshortëve, për shkaqe të parapara me ligj dhe në procedurë ligjore.³ Martesa mund të zgjidhet me shkurorëzim vetëm me padi private të ngritur nga bashkeshorti, ose bashkeshortët bashkarisht, në procedurë për zgjidhje të martesës me shkurorëzim e cila zhvillohet pranë gjykatës kompetente. Nga ky përkufizim rezultojnë këto veçori më kryesore të shkurorëzimit:

a) *ekzistimi i martesës së vlefshme*

b) *shkurorëzimi bëhet gjatë jetës së bashkëshortëve,*

c) *martesa mund të shkurorëzohet vetëm për shkaqe të parapara me ligj,*

ç) *shkurorëzimi bëhet në procedurë gjyqësor*⁴,

¹ Një ndër shtetet, ku dy persona të gjinisë së njëjtë mund të hyjnë në martesë ose mund të bashkëjetojnë ndërmjet tyre është Holanda, ku legjislacioni në fuqi që nga viti 1999 i lejon personat e gjinisë së njëjtë të lidhin martesë.

² Nen 34 Ligji për familjen e Republikës së Maqedonisë (Gazeta zyrtare e R.M, nr.153, 20.10.2014) në vazhdim do të referohemi LF.

³ Ruzhdi Berisha Doracaku për përgatitjen e provimit të jurisprudencës, Prishtinë fq.503

⁴ Abdulla Aliu & Haxhi Gashi E drejta familjare fq.158

Shkurorëzimi është pjesë përbërëse e çdo shoqërie dhe e ka përcjellur atë në të gjitha fazat e zhvillimit të saj. Volteri thoshte se: shkurorëzimi lind disa javë pas martesës. Në rastet kur jeta e përbashkët tani më nuk është alternativa e vetme për të vazhduar më tej, shumica e bashkëshortëve përgatiten të përballen sfidën e jetesës në mënyrë të pavarur dhe të ndarë. E gjitha kjo është pasojë e problemeve të papërballueshme të cilat i përkasin martesës së tyre, duke pasur të drejtën e vendimmarrjes së përbashkët se a do t'i japin asaj fund me anë të institucionit të shkurorëzimit.

Edhe pse, shpesh nga ajo se sa flitet për shkurorëzimin, mund ta fitojmë përshtypjen se shkurorëzimi është fenomen i ri dhe modern, por kjo s'është e vërtetë. Shkurorëzimi ka ekzistuar dhe ekziston sa edhe martesat e keqe, mirëpo kanë ndryshuar mënyra dhe shkaqet e shkurorëzimit. Pra, shkurorëzimi është institucion i lashtë, pasojë natyrale e çrregullimeve të cilat çdo here e kanë ndjekur jetën e përbashkët të burrit dhe gruas, pa marrë parasysh mënyrën e rregullimit dhe funksionin që e ka pasur martesat gjatë gjithë historisë njerëzore e deri më sot.

Impakti i shkurorëzimit përveç të bashkëshortët vërehet tek fëmijët të cilët mund të themi që i vuajnë pasojat në mënyrë të veçantë.

Le të përmendim disa prej tyre:

- *Shkurorëzimi ndikon në pamundësinë e formimit normal të fëmijës, sepse fëmija ka nevojë për dy modele, të babait dhe të nënës, për autoritetin e babait dhe për dhembshurinë e nënës. Një fëmijë me prindër të shkurorëzuar, djalë apo vajzë, do të ketë konfuzion në formimin e personalitet të tij sepse siç thamë, mungon modeli i prindit që ai duhet të imitojë.*
- *Te fëmijët krijohet një stres i vazhdueshëm në kërkim të shkakut se pse prindërit e tyre u ndanë. Fëmija, duke qenë i paafte për të gjykuar sjelljet e të rriturve, mund të krijojë një gjykim të gabuar për prindërit, deri në urrejtje. Ose fëmija ndihet fajtor dhe shkaktar i këtij shkurorëzimi dhe i paafte për t'i bashkuar prindërit dhe kjo e torturon çdo ditë zemrën e tij.*

- *Fëmijët me prindër të shkurorëzuar ndihen të ndryshëm nga fëmijët e tjerë me familje të rregullt. Kjo gjë u krijon stres, i mbyll në vetvete, i bën të mos jenë të çiltër në të shprehur, gjë që krijon çrregullim psikologjik dhe marrëdhënie jokorrekte me të tjerët.*
- *Shkurorëzimi krijon probleme ekonomike dhe fëmijët me prindër të shkurorëzuar detyrohen të rriten në kushte të vështira, jo me arsimimin e duhur, ose detyrohen të punojnë që në moshë të mitur për të plotësuar mungesat ekonomike që vijnë për shkak të shkurorëzimit të prindërve.*
- *Fëmijët rriten pa dashurinë natyrale të të dy prindërve së bashku dhe kjo do të ndikojë në jetën e tyre private, sidomos kur ata do të krijojnë familjen e tyre, duke rrezikuar të bëjnë të njëjtën gjë në jetë si prindërit e tyre. Kështu shembulli i keq shkurorëzimi rrezikon të përsëritet e të përhapet nga brezi në brez.*

1.1. Zhvillimi historik i shkurorëzimit

Shkurorëzimi është një dukuri shumë e lashtë, e cila njihej dhe rregullohej nga e drejta zakonore e shumë popujve duke përfshirë edhe atë të shqiptarëve, legjislacionin e lashtë romak, grek, bizantinët etj.⁵ Historiku i shkurorëzimit pothuajse ëshët drejtuar kundër gruas dhe favorizimit të burrit, edhe shkaqet e shkurorëzimit e goditnin gruan ku si të tilla ishin mospasja e fëmijëve, shkelja e besnikërisë bashkëshortore etj.⁶ Mirëpo, krahas këtyre kishim edhe legjislacionet, të cilat ishin nën ndikimin e fuqishëm të kishës katolike, si p.sh. Italia, Spanja etj, tek të cilat deri në dhjetëvjecarin e fundit të shek.XX nuk ishte lejuar shkurorëzimi. Sot, shkurorëzimi njihet dhe rregullohet nga legjislacionet e pothuajse të gjitha shteteve të Europës dhe të botës.⁷ Kështu që dalim në përfundimin se gjatë zhvillimit historik janë zhvilluar dy sisteme të shkurorëzimit: ato që kanë ndaluar dhe ato që kanë lejuar shkurorëzimin.

Sistemet që e kanë ndaluar shkurorëzimin janë ato shtete të cilat kanë qenë në ndikimin e kishës katolike p.sh Italia, Spanja Irlanda, Kili, Brazili etj, këto vende e kanë konsideruar martesën e shejntë si lidhje hyjnore e të pashkëputshme deri në vdekje. Në vend të shkurorëzimit ishte zhvilluar institucioni i ndarjes nga shtrati dhe tryeza (*separatio quod thorum et mensam*). Ndalimi i shkurorëzimit shkaktonte krijimin e lidhjeve faktike, bashkësive jashtëmartesore. Kjo mund të jetë një argument që dëshmon se ndalesa e shkurorëzimit ishte një qëndrim i gabuar, gjithashtu shikuar dhe aspektin e të drejtave të njeriut, ishte një shkelje e të drejtës për të lidhur martesë në bazë të vullnetit të lirë. Andaj mund të themi se sot nën ndikimin e të drejtës moderne pothuajse të gjitha këto legjislacione lejojnë shkurorëzimin si menyrë e zgjidhjes të martesës.⁸

Sistemet që e lejojnë shkurorëzimin: në kuadër të tyre kemi ato sisteme që;

a) Me lehtësi lejojnë shkurorëzimin, janë ato sisteme të cilat bazohen në një liri absolute të shkurorëzimit. Këto sisteme kryesisht bazohen në të Drejtën e Sherijatit, përkatësisht këto janë shtetet muslimane.

⁵ Valentina Zace “ Marrëdhëniet martesore sipas legjislacionit shqiptar”, fq.124 Tirane 1999

⁶ Gani Oruci “E drejta familjare-ligjerata te autorizuar” Prishtine,1994

⁷ Valentina Zace “Marrëdhëniet martesore sipas legjislacionit shiptar” Tiranw 1994, fq.125

⁸ Abdulla Aliu & Haxhi Gashi vep.e cit, fq. 161

b) Sistemet që lejojnë shkurorëzimin si sanksion, janë shtetet të cilat kryesisht bazohen në fajësinë e bashkëshortit për shkak të shkeljes së detyrimeve bashkëshortore. Ky sistem zakonisht aplikohet në Francë dhe në vendet anglosaksone.

c) Sistemet që e lejojnë shkurorëzimin e martesës për shkak të crregullimit serioz të marrëdhënieve bashkëshortore, e lejojnë si mjet shërues. Ky sistem ndryshe quhet dhe sistem i shkakut të përgjithshëm (relativ) të shkurorëzimit⁹. Këtë sistem e kishte edhe Shqipëria që nga viti 1966.

d) Sistemi i kombinuar, është sistem i cili në vete përfshin si elementet e sistemit objektiv pra të crregullimit të marrëdhënieve bashkëshortore por edhe elementet e parashikuara me ligj. Ky sistem fillimisht është përhapur në legjislacionin familjar të Austrisë, Gjermanisë, Zvicrës, Turqisë e më vonë edhe në shtetet tjera. Sipas tij shkurorëzimi mund të kërkohet për shkaqe të parapara me ligj.¹⁰

Sipas Ligjit për Familjen të Republikës të Maqedonisë martesa e vlefshme mund të zgjidhet me shkurorëzim sipas kushteve të parapara me ligj. Nisur nga kjo mund të thuhet se legjislacioni ynë familjar pranon sistemin që e cilëson shkurorëzimin si mjet shërues, ose më saktësisht si mjet që u jep fund edhe juridikisht atyre martesave të cilat faktikisht nuk funksionojnë, pra, martesa të vdekura të cilat vetëm formalisht si të tilla ekzistojnë domethënë martesa të cilat e kanë humbur qëllimin e tyre për bashkëshortin paditës ose për të dy bashkëshortët.

⁹ Valentine Zace vep.e cit, fq 125

¹⁰ Abudlla Aliu& Haxhi Gashi vep. E cit, fq. 163

1.2. E drejta në shkurorëzim sipas Ligjit për familje të RM-ës

Ligji për familjen, si akt i përgjithshëm normativ juridik paraqet kodifikim në të cilin në një mënyrë të përgjithshme dhe gjithëpërfshirëse rregullohet materia nga marrëdhëniet familjare, si dhe, paraqet etapë të rëndësishme në zhvillimin dhe përsosjen e regullativës juridike edhe në këtë sferë të marrëdhënieve shoqërore në Republikën e Maqedonisë. Ligji për familjen rregullon një sërë çështjes siç janë: martesën dhe familjen, marrëdhëniet në martesë, shkurorëzimin, format e caktuara të mbrojtjes së veçantë të familjes, dhunën në familje, adoptimin, kujdestarinë, dhënien e ushqimit si dhe procedurën gjyqësore në kontestet bashkëshortore dhe familjare dhe procedurën për shqiptimin e masave të përkohshme për mbrojtjen nga dhuna familjare.¹¹

Sipas Ligjit për familjen, martesa është bashkësi jetësore e rregulluar me ligj e burrit dhe gruas, në të cilën realizohen interesat e bashkëshortëve, familjes dhe shoqërisë, ndërsa marrëdhëniet në mes bashkëshortëve krijohen me vendim të lire të burrit dhe të gruas për të lidhur martesë dhe mbështeten në barabarësinë ndërmjet tyre, respektim të ndërsjellë dhe ndihmën reciproke¹². Pra, në qoftë se marrëdhëniet nuk zhvillohen sipas këtij koncepti për martesën, ose sipas pritjeve të bashkëshortëve, në atë rast është e lejuar që martesa e tillë të zgjidhet gjatë jetës së bashkëshortëve, nën kushtet e parapara me këtë ligj. Në ligjin në fjalë është paraparë që procedura kontestimore parashtrohet me padi, dhe kjo e drejtë i takon çdonjërit nga bashkëshortët. Këtë padi bashkëshortët mund ta parashtrojnë bashkërisht, në bazë të marrëveshjes së tyre të ndërsjelltë ose të njëjtën mund ta paraqes njëri nga bashkëshortët për shkaqet që do t'i paraqesim në pjesën që ka të bëjë me shkaqet e shkurorëzimit.

Bashkëshortët me marrëveshje të dyanshme mundën të kërkojnë shkurorëzim duke parashtruar padi në gjykatën kompetente. Gjykata do të sjell vendim për shkurorëzim në bazë të marrëveshjes së ndërsjelltë të bashkëshortëve nëse vërteton se atë pajtim e kanë arritur në mënyrë të lirë, serioze dhe të pakthyeshme.¹³ Nëse njëri nga bashkëshortët paraqet padi për shkurorëzim, kurse bashkëshorti tjetër me së voni deri në deri në përfundimin e seancës kryesore gjyqësore, deklaron shprehimisht se nuk e kundërshton bazushmerinë e kërkesëpadisë, do të konsiderohet se bashkëshortët kanë paraqitur propozim tëpërbashkët për shkurorëzim me

¹¹ Nen 1, LF

¹² Nen 6, LF

¹³ Nen 39, par 1,3, LF

marrëveshje. Në rastet e marrëveshjes së përbashkët të bashkëshortëve gjykata e cila zhvillon procedurën e shkurorëzimit e kashumë më lehtë të sjell vendimin për ndarjen e tyre. Mjet juridik për iniciimin e procedurës së shkurorëzimit përveç marrëveshjes (propozimit) së përbashkët të bashkëshortëve është edhe kërkesa e njërit bashkëshort pra meanë të padisë së ngritur nga ana e njërit bashkëshort.¹⁴

Martesa mund të shkurorëzohet me kërkesën e njërit nga bashkëshortet, në qoftë se marrëdhëniet bashkëshortore janë crregulluar deri në atë masë sa jeta e përbashkët është bërë e padurueshme.¹⁵ Gjithashtu padi të njëanshme për shkurorëzim mund të parashtrojë bashkëshorti nëse bashkësia (jeta) martesore faktikisht ka pushuar se ekzistuari për më tepër se 1 vit.¹⁶ Nga cka shqytuar më sipër arrijmë në përfundim se në vendin tonë mënyrat e shkurorëzimit janë 2 edhe atë:

- a) Shkurorëzimi me marrëveshje të përbashkët të dy bashkëshortëve
- b) Shkurorëzimi me padi të njëanshme nga ana e njërit bashkëshort
- c) Shkurorëzimi me padi për shkak të pushimit faktik të jeteës martesore për më shumë se një vit.

Sipas legjislacionit pozitiv të R. Maqedonisë shkaqet e shkurorëzimit janë ato fakte dhe rrethana që lindin pas lidhjes të martesës të cilat i shtyjnë bashkëshortet drejt marrjes të vendimit për shkurorëzim të martesës së tyre. Duke u nisur nga neni 39 i Ligjit për familje të R. Maqedonisë ekzistojnë 3 shkaqe, arsye për shkurorëzim të martesës edhe atë:

- 1) Marrëveshja e përbashkët për shkurorëzim të bashkëshortëve,
- 2) Përkeqësim i marrëdhënieve bashkëshortore deri në atë masë sa jeta e përbashkët bëhet e padurueshme,
- 3) Pushimi faktik i jetës martesore për më shumë se 1 vit.

¹⁴ Ackerman, M.J., & Ackerman, M.C. (1997). Custody evaluation practice: A survey of experienced professionals (revisited). Professional Psychology: Research and Practice, fq.54

¹⁵ Nen 40, LF

¹⁶ Nen 41, LF

1.2.1. Procedura e shkurorëzimit

Shkurorëzimi është përfundim ligjor i martesës,¹⁷ ai mund të bëhet vetëm brenda procedurës gjyqësore, pavarësisht se a ekziston marrëveshja për shkurorëzim apo është paraqitur padia. Kusht i domosdoshëm për fillimin e procedurës, përkatësisht gjykimit të një çështje të tillë është që gjykatës kompetente ti jetë paraqitur padia apo propozimi si akt për inicimin e procedurës¹⁸. Shkurorëzimi realizohet në procedurë të veçantë që është e rregulluar me dispozitat e Ligjit për familjen, mirëpo gjithashtu zbatohen edhe rregullat e përgjithshme të parapara në Ligjin për procedurën kontestimore dhe jashtëkontestimore si dhe Ligjin për pronësinë dhe të drejtat tjera sendore.

Shkurorëzimi i martesës mund të bëhet vetëm në rast se dy bashkëshortët kanë lidhur martesë të vlefshme midis tyre. Pra, kërkohet që martesë mos të jetë prekur nga shkaqe pavlefshmërie, pasi, në të kundërtën, nëse martesë është e pavlefshme deklarohet pavlefshmëria ose nuliteti i saj dhe nuk mund të bëhet fjalë për shkurorëzim.¹⁹

Bashkëshortët nuk do të parashtrojnë padi për shkurorëzim gjatë shtatzënisë së gruas dhe derisa fëmija i tyre i përbashkët ti ketë mbushur një vit. Se bashku me propozimin për shkurorëzim me marrëveshje të dyanshme, bashkëshortët janë të detyruar të parashtrojnë marrëveshjen me shkrim për përkujdesje, edukim dhe ushqim të fëmijëve të tyre të përbashkët si dhe propozimin me shkrim mbi atë se si kontaktet personale mes fëmijës dhe të dy prindërve do të garantohen në të ardhmen²⁰

Gjatë zhvillimit të procedurave lidhur me kontestet martesore, gjykata me vendim duke u bazuar në padi, mund të caktojë masë të përkohshme për sigurimin e mbajtjes financiare për bashkëshortin dhe vendosjen e tij. Kjo nxjerr në pah parimin e mbrojtjes të vecantë gjatë procedurës të shkurorëzimit të martesës.

Në kontestet martesore kompetencën territoriale përveç gjykatës me kompetencë të përgjithshme territoriale, kompetente është edhe gjykata në territorin e së cilës bashkëshortët

¹⁷ Ruzhdi Berisha vep, cit, fq 503

¹⁸ Valentina Zace vep, e cit, fq.141

¹⁹ Arta Mandro Balili, Vjollca Meçaj, Tefta Zaka, Arjana Fullani, *E drejta familjare*, Tiranë, 2006, f.377-378.

²⁰ Abdulla Aliu & Haxhi Gashi vep, e cit, fq166

kanë pasur vendbanimin e fundit të përbashkët.. Procedurën në kontestet martesore në shkallen e parë e zhvillon dhe i merr vendimet kolegji i përbërë prej një gjyqtari dhe dy gjyqtarëve porotë, kurse në shkallen e dytë kolegji prej tre gjyqtarëve. Kujdestari mund të parashtroj padi për shkurorëzim në emër të bashkëshortit i cili vuan nga sëmundjet psikike të diagnostifikuara, ose në emër të personit të paaftë për të vepruar vetëm me pëlqimin e mëparshëm të Organit të Kujdestarisë. Publiku përjashtohet nga procedurat e kontestit martesor.²¹

Mirëpo duke u bazuar në dispozitat e Ligjit për Familje, para së të kryhet procedura e shkurorëzimit, gjykata dhe secili person tjetër i interesuar për prishjen e martesës duhet të ketë parasysh parimet themelore si në vijim:

- *Institucioni i martesës duhet të ruhet.*
- *Bashkëshortët në martesë e cila është shkëputur duhet të inkujarohen të marrin të gjitha hapat e zbatueshme përmes këshillimit për martesë, procedurave të pajtimit të parapara në këtë ligj, ose tjetër për të ruajtur martesën.*
- *Martesa e cila në mënyrë të pathyeshme është shkëputur duhet të shuhet:*
- *Me një minimum shqetësimi për palët dhe fëmijët e prekur*
- *Të zgjidhet në atë mënyrë që të promovojë sa më mirë marrëdhëniet e vazdhueshme mes palëve dhe fëmijëve të prekur si është e mundur nga rethanat dhe pa shpenzime të paarsyeshme të përfshira në lidhje me procedurat që duhet ndjekur*
- *Se çdo rezik për të keqen ose dhunë ndaj bashkëshortëve dhe fëmijëve të shmanget.*

²¹ Po aty fq.54

1.2.2. Zhvillimi i procedurës së shkurorëzimit (fazat e procedurës)

Shkurorëzimi realizohet në një procedurë të caktuar juridike të paraparë me dispozitat ligjore. Shkurorëzimi do të jetë i plotfuqishëm vetëm në qoftë se realizohet para organit kompetent gjyqësor.

Procedura e shkurorëzimit është procedurë e veçantë që është rregulluar me Ligjin e familjes së RM, ku në mënyrë subsidiare gjithashtu zbatohen edhe dispozitat e Ligjit për procedurën kontestimore, jashtëkontestimore dhe të Ligjit për pronësinë dhe të drejtat tjera sendore. Me dispozitat materialo-juridike për shkurorëzim në Ligjin për familjen (neni 39 – 43) është paraparë e drejta e bashkëshortëve që bashkërisht (me marrëveshje të përbashkët padi me propozimim) ose në mënyrë të njëanshme (me padi) të kërkojnë shkurorëzimin.

Konteste martesore, sipas Ligjit për familjen, janë kontestet për anulimin e martesës (nenet 35-38) dhe shkurorëzim të martesës (nenet 39-43), ndërsa sipas Ligjit për procedurën kontestimore, si konteste martesore konsiderohen edhe kontestet për vërtetimin e ekzistimit ose mosekzistimit të martesës.

Për të gjithë kontestet martesore kompetente janë gjykatat me kompetencë të përgjithshme territoriale. Në shkallë të parë ato janë gjykatat themelore, ndërsa në shkallë të dytë gjykatat e apelit. Në kontestet martesore krahas gjykatës me kompetencë të përgjithshme territoriale, kompetencë territoriale ka edhe gjykata në territorin e të cilit bashkëshortët e kanë pasur vendbanimin e fundit të përbashkët (Ligji për procedurën kontestimore neni 46, në tekstin e mëlutjeshëm LPK²² dhe neni 228 i LF). Kjo dispozitë, kur është fjala për kontestet martesore është sjellë me qëllim të ekonomizimit të procedurës, që kontesti të zhvillohet atje ku edhe janë paraqitur shkaqet e atij kontesti, ku, sipas rregullës, edhe gjinden faktet që duhet ti paraqesë gjykata. Në rastin konkret, pra, bëhet fjalë për kompetencë territoriale të zgjedhur²³, pasi që nga paditësi varet se a do ta paraqes padinë në gjykatën me kompetencë të përgjithshme territoriale ose në gjykatën në territorin e të cilit e ka pasur vendbanimin gjegjësisht vendqëndrimin e fundit (LPK neni 39 alineja 1 dhe 2).

²² Neni 46, aliena 1 dhe 2 Ligji për procedurën kontestimore, Gazeta zyrtare nr.79/05.

²³ Kiril Çavdar, *Komentar na Zakonot za semejstvoto*, Shkup, 1998, neni 228, f.378.

Në RM, kur kemi të bëjmë me raste të thjeshta të shkurorëzimit, procedura e tillë mund të përfundojë edhe për dy deri më tre javë, sepse edhe zakonisht procedurat e shkurorëzimit nuk janë procedura të komplikuar (kjo vlen nëse në martesë të tillë nuk ka fëmijë dhe pasuri të përbashkët e cila duhet të ndahet). Gjyqtarët pranë gjykatës themelore procedurat e shkurorëzimit i konsiderojnë si një ndër procedurat më të thjeshta dhe më pakë të komplikuar. Pra, nëse bashkëshortët vendosin që me marrëveshje të shkurorëzohen, ndërsa nuk kanë fëmijë të mitur, mjafton që vetëm ta paraqesin propozimin për shkurorëzim me marrëveshje reciproke si dhe dokumentet tjera të nevojshme dhe që në seancën e parë gjyqësore të përfundojë martesa e tyre.²⁴

1.3. Format e inicimit të procedurës së shkurorëzimit të martesës

Nëse bashkëshortët kërkojnë që të shkurorëzohen me marrëveshje reciproke, në atë rast procedura kontestimore inicohet me *padinë me propozim për shkurorëzim në bazë të marrëveshjes reciproke të bashkëshortëve* (neni 39 dhe 229, alineja 2 i LF).

Procedura për shkurorëzim mund të inicohet me padie cila në vete përmban kërkesën e njërit bashkëshort për shkurorëzim, dhe e njëjta mund të paraqitet në tre raste (neni 40, 41 dhe 229 alineja 1 i LF):

- a) *nëse marrëdhëniet bashkëshortore janë keqësuar deri në atë shkallë sa që jeta e përbashkët është bërë e padurueshme*
- b) *me padi me propozim të përbashkët për shkurorëzim*
- c) *nëse bashkësia martesore, faktikisht ka pushuar së ekzistuari më gjatë se 1 vit*

Pra, bashkëshortët janë ata të cilët do të vendosin se cilin nga shkaqet e mësipërme do ta marrin si bazë për shkurorëzimin e tyre.

²⁴ Nga intervista me gjyqtarë pranë gjykatës themelore Shkup 2, Shkup, të cilët i udhëheqin kontestet martesore.

1.3.1. Shkurorëzimi i martesës në bazë të marrëveshjes reciproke të bashkëshortëve

Bashkëshortët të cilët vendosin që bashkërisht të kërkojnë shkurorëzimin e martesës së tyre, atë e bëjnë me padi me propozim propozim (kërkesën)²⁵ për shkurorëzim me marrëveshje reciproke, që është paraparë në Ligjin për familjen të RM.²⁶

Kur martesë shkurorëzohet në këtë mënyrë, gjykata nuk hynë në shqyrtimin e shkaqeve të shkurorëzimit, sepse bazë e mjaftueshme për këtë formë të shkurorëzimit është vullneti i përbashkët i bashkëshortëve, por vetëm vertetohet nëse ata pajtim e kanë arritur në mënyrë të lirë, serioze dhe të pakthyeshme.²⁷ Në bashku me kërkesën ose propozimin për shkurorëzim me marrëveshje reciproke, bashkëshortët, nëse kanë fëmijë të mitur të përbashkët, apo fëmijë madhorë të cilëve u është zgjatur e drejta prindërore, duhet t'i dorëzojnë gjykatës edhe marrëveshjen për mënyrën e rregullimit të çështjeve që janë pasojë ose me mirë të themi rrjedhojë e vetë procesit të zgjidhjes së martesës e ajo është marrëveshja për mënyrën e ushtrimit të të drejtave dhe detyrave prindërore si dhe për ushqimin dhe edukimin e fëmijëve (neni 39 alineja 2 dhe neni 253 alineja 1 i LF).

Bashkëshortët në marrëveshjen përkatësisht në padin me propozim për shkurorëzim të martesës së tyre gjithnjë duhet ta kenë parasysh dhe ti kushtojnë rëndësi të veçantë mbrojtjes së interesit më të mirë të fëmijës. Nëse prindërit nuk e mbajnë parasysh këtë parim të rëndësishëm, atëherë i takon gjykatës që, siç u theksua më sipër, në bazë të mendimit paraprak të marrë nga qendra për punë sociale t'u bëjë të ditur se duhet t'i rregullojnë kushtet e marrëveshjes së tyre në mënyrë që të mundësohet mbrojtja e interesit të fëmijës duke u sugjeruar që t'i bëjnë përmasimet e duhura në marrëveshjen e tyre. Prindërit kanë detyrë dhe të drejtë të kujdesen për ngritjen, ruajtjen, zhvillimin, edukimin dhe arsimimin e fëmijëve të tyre. Të drejtën prindërore prindërit duhet ta kryejnë në pajtim me interesat dhe nevojat e fëmijëve dhe interesat e shoqërisë (neni 8 alineja 2 dhe 3 i LF).

²⁵ Kërkesa për zgjidhjen e martesës është parashtrimi që të dy bashkëshortët i bëjnë gjykatës, ku shprehin vullnetin e tyre për të nisur procesin gjyqësor të zgjidhjes së martesës me pëlqimin e ndërsjell të tyre – Arta Mandro Balili, Vjollca Meçaj, Tefta Zaka, Arjana Fullani, *E drejta familjare*. Tiranë, 2006, f.388.

²⁶ Nen 39 dhe 229, al 2, LF

²⁷ Nen 39, LF

Padia me propozim per shkurorëzim te martesës, duhet t'i përmbaje në vete këto elemente:

- *Çertifikatën nga libri amzë i të martuarve,*
- *Çertifikatën nga libri amzë i të lindurve (nëse ka fëmijë në martesë) dhe*
- *Marrëveshjen për mënyrën e kryerjes së të drejtave dhe detyrave prindërore si dhe për ushqimin dhe edukimin e fëmijëve.*

Nga ajo që theksua më sipër, vijnë në përfundim, se shkurorëzimi i martesës me pajtimin reciprok të bashkëshortëve, është një ndër mënyrat më liberale dhe më të thjeshta të shkurorëzimit, mirëpo, jo edhe mënyrë më e aplikuar e shkurorëzimit nga ana e bashkëshortëve gjatë zgjidhjes së martesës së tyre. Numri i shkurorëzimeve i iniciuar me padi nga ana e njërit bashkëshort, qoftë për shkak të keqësimit të marrëdhënieve bashkëshortore ose pushimit faktik të bashkësisë martesore më tepër se 1 vit, është shumë më i madh në krahasim numrin e propozimeve për shkurorëzim në bazë të marrëveshjes reciproke të bashkëshortëve. Roli i gjykatës tek kjo formë kufizohet vetëm në vërtetimin e sinqeritetit të vullnetit të bashkëshortëve për shkurorëzim, të sigurohet se marrëveshja është sjellë në bazë të vullnetit të lirë dhe serioz të tyre, se asnjëri prej tyre nuk kanë ndikuar në vullnetin e tjetrit që të lidhet një marrëveshje e tillë, etj.²⁸

²⁸ Nga analiza e kërkesave për shkurorëzim të paraqitura pranë gjykatës, akteve ndimeve të sjella nga ana e gjykatës si dhe intervista e realizuar me kryetarin e gjykatës Mersim Marku /Diber 2017/

1.3.2. Shkurorëzimi i martesës me kërkesë të njërit bashkëshort për shkak të jetës së padurueshme.

Marrëdhëniet në mes bashkëshortëve themelohen në vullnetin lirë të burrit dhe gruas për të lidhur martesë, në barazinë ndërmjet tyre, respektim të ndërsjellët dhe ndihmën reciproke²⁹ Pra, martesa ose marrëdhëniet bashkëshortore bazohen në dashuri, barazi, respekt, tolerancë dhe ndihmë reciproke, mirëpo në rast të mosrespektimit të këtyre parimeve ose në rast të humbjes së aftësisë për t'i ruajtur ose rindërtuar marrëdhëniet bashkëshortore (si dhe marrëdhëniet familjare) mund të vije deri tek zgjidhja e martesës.

Ligji i mundëson bashkëshortit i cili nuk është i kënaqur me martesën e tij, gjendjen e cila mbretëron në marrëdhënien e tillë bashkëshortore, në mënyrë të njëanshme të kërkojë zgjidhjen e martesës. Në këtë rast, procedurën gjyqësore paditësi e inicion me paraqitjen e padisë në gjykatën kompetente, me kërkesë për zgjidhjen e martesës për shkak të keqësimit të marrëdhënieve bashkëshortore deri në atë shkallë sa që jeta e përbashkët është bërë e padurueshme, pa u detyruar që më hollësisht t'i sqarojë shkaqet që kanë sjellë deri tek keqësimi i marrëdhënieve të tilla.³⁰ Gjendja e çrregulluar e marrëdhënieve bashkëshortore, e cila duhet që të vërtetohet nga ana e gjykatës, manifestohet objektivisht dhe nuk nënkuptohet vetëm si pakënaqësi subjektive e bashkëshortit i cili kërkon shkurorëzimin e martesës. Kjo domethënë se edhe personat e tjerë munden që ta vërejnë se martesa është në krizë (p.sh. bashkëshortët nuk flasin në ndërmjet veti ose njëri tjetrit i drejtohen në mënyrë armiqësore, nuk dalin bashkë etj).³¹

Shkurorëzimit, vjen në konsideratë vetëm në rast të çrregullimit të rëndë dhe të vazhdueshëm të marrëdhënieve bashkëshortore, atëherë kur ndërmjet dy partnerëve nuk ekziston më komunikimi, është thyer ndjenja, intimiteti, dhe padyshim që marrëdhëniet nuk funksionon më, duke shkaktuar një stres të përgjithshëm tek të gjithë anëtarët, në këtë rast shkurorëzimi deri diku është i arsyeshëm. Medoemos të ekzistojë elementi i “vazhdueshëm”, sepse mosmarrëveshjet jo të shpeshta, të rastit, pra të ashtuquajturat kriza më të vogla që kohë pas kohe paraqiten pothuaj në çdo marrëdhënie bashkëshortore, nuk mund dhe nuk duhet të jenë shkak për

²⁹ Nen 6, LF

³⁰ Nen 40, dhe 229, LF

³¹ Mira Alinçiq, Ana Bakariç Abramovic, Dubravka Hrabar, Dijana Jakovac Lozić, Alexandra Koraç, *Obiteljsko pravo*, Zagreb, 2001, f.110.

paraqitjen e kërkesë për shkurorëzim. Në raste të tilla, nga bashkëshortët, pritet që, me më shumë ose më pakë mund dhe vullnet t'i tejkalojnë situatat e tilla, pasi që shkurorëzimi është një situatë tepër stresuese për të gjithë anëtarët e familjes që e përjetojnë atë situatë, prandaj është më mirë dhe më e preferueshme kur është e mundur, ti iket një gjëje të tillë.

Padia për shkurorëzim sipas LF nen 40,41 nga njëri bashkëshort mund të paraqitet në dy raste edhe atë:

- *Nëse marrëdhëniet bashkëshortore janë keqësuar deri në atë shkallë sa që jeta e përbashkët është bërë e padurueshme dhe*
- *Nëse bashkësia martesore, faktikisht ka pushuar së ekzistuari më gjatë se 1 vit.*

Praktika gjyqësore tregon se nga kërkesat e paraqitura për shkurorëzim, numri më i madhë i tyre paraqiten nga ana e njërit bashkëshortë dhe arsyet janë nga më të ndryshmet: për shkak të keqësimit të marrëdhënieve bashkëshortore, tradhëtisë, mbarimit faktik të bashkësis martesore më gjatë se një vitë, paknaqësis së paraqitur nga ana e njërit bashkëshort, etj.

1.4. Subjektet që kanë te drejtë në padi për shkurorëzim të martesës

Padinë për shkurorëzim mund ta paraqesin të dy bashkëshortët, qoftë për shkak se marrëdhëniet bashkëshortore janë keqësuar deri në atë shkallë sa që jeta e përbashkët është bërë e padurueshme ose për shkak se bashkësia martesore, faktikisht ka pushuar së ekzistuari më gjatë se 1 vit. Bashkëshorti i cili kërkon zgjidhje të martesës për cilin do nga shkaqet e përmendura më sipër, duhet të paraqes padi në gjykatë.

Të drejt në padi kanë ekskluzivisht vetëm bashkëshortët, domethënë ajo është e lidhur për personalitetin e tyre dhe nuk kalon në trashëgimtar. Trashëgimtarët e bashkëshortit të vdekur, i cili e ka paraqitur padinë për shkurorëzim mund të kërkojnë vetëm vërtetimin se padia për anulim, gjegjësisht shkurorëzim ka qenë e themeluar. Kërkesa për vërtetimin e padis së përmendur më sipër mund të theksohet në procedurën e cila më është iniciuar nga bashkëshorti i

vdekur, nëse nga vdekja e tij nuk ka kaluar më tepër se gjashtë muaj. Pas kësaj periudhe procedura ndërpritet.³²

Sa i përket mënyrës së paraqitjes së padisë për shkurorëzim, siç u theksua më sipër, mund të paraqitet personalisht ose nëpërmjet përfaqësuesit. Përfaqësuesi, që të mundet ta paraqes padinë, duhet të ketë autorizim special në të cilin do të jen të shënuara lloji i padisë dhe arsyet për të cilat padia mund të paraqitet.³³ Nëse bëhet fjalë për person të sëmurë psiqikisht, gjegjësisht për persona të cilët kanë ngecur në zhvillimin e tyre psiqik , padinë për shkurorëzim mund ta paraqesë kujdestari i tij por vetëm me lejen paraprake të Qendrës për punë sociale.³⁴

Padia i parashtrahet gjykatës me kompetencë të përgjithshme territoriale ose gjykatës në territorin e së cilës bashkëshortët e kanë pasur vendbanimin gjegjësisht vendqëndrimin e fundit të përbashkët.

³² Nen230, LF

³³ Nen231, LF

³⁴ Nen 18, al 1,2 LF

1.5. Seanca për pajtimin e bashkëshortëve

Veçanti e procedurës së shkurorëzimit është ajo së në të, para se të fillohet me përcaktimin e shkaqeve të cilat e bëjnë të bazuar kërkesën për shkurorëzim, pas pranimit të padisë për shkurorëzim ose padisë me propozim për shkurorëzim me marrëveshje reciproke, para dorëzimit të padisë të paditurit, zbatohet procedurë e veçantë, seanca për pajtimin e bashkëshortëve.

Procedura e pajtimit është fazë e vecantë në procedurën e shkurorëzimit përmes së cilës tentohet të arrihet pajtimi i bashkëshortëve dhe pengimi i zgjidhjes së martesës.³⁵ Nga momenti i pranimit të padisë nga gjykata, ajo ka për obligim të fillojë procedurën e pajtimit të bashkëshortëve. Ligjvënësi e ka kushtëzuar nxjerjen e aktykimit për shkurorëzim vetëm pasi gjykata të k etë zhvilluar procedurën për pajtim. Seanca për pajtimin e bashkëshortëve është proces në të cilin pala e tret e paanshme (gjykata ose QPS) u ndihmon bashkëshortëve që të negociojnë lidhur me tejkalimin e mosmarrëveshjeve dhe marrjen e një vendimi të përbashkët që do të jetë i përshtatshëm për të dy. Personi i cili udhëheqë me seancën për pajtimin e bashkëshortëve (qoftë punëtori në QPS ose kryetari i trupi gjykues) nuk ka autoritetin për t'u imponuar palëve një zgjidhje, por vetëm duhet t'u sugjerojë zgjidhje të mundshme që do të jenë më të përshtatshme për ta dhe në këtë mënyrë t'u ndihmojë në tejkalimin e mosmarrëveshjeve dhe vazhdimin e mëtejshëm të martesës.

Mirëpo, që të vijë deri tek pajtimi i bashkëshortëve, që seanca të jetë efektive dhe që përpjekjet të kenë rezultate afatgjate, duhet të mbizotërojë një nivel i konsiderueshëm tolerance, faljeje dhe dëshire të dyanshme nga ana e bashkëshortëve, që të realizohet zgjidhja e vërtet, mirëpo gjithmonë gjatë kësaj, në qendër të vëmendjes të jetë mbrojtja e interesit më të mirë të fëmijëve.³⁶

Në kohën më të re, në terminologjinë juridiko-familjare në vend të institutit të pajtimit të bashkëshortëve përdoret termi *ndërmjetësimi familjar*, me të cilin emërohen procedurat e

³⁵ Abdulla Aliu & Haxhi Gashi vep.e cit,fq.170

³⁶ Nga intervista me punëtorët social të punësuar pranë Qendrës ndërkomunale për punë sociale Diber 2016

ndryshme jashtëgjyqësore të dedikuara zgjidhjes jokonfliktuale të mosmarrëveshje në mes anëtarëve të familjes.³⁷

Sipas të drejtës së RM-ës, seanca për pajtimin e bashkëshortëve ka të bëjë vetëm me kontestet martesore dhe zgjidhjen e mosmarrëveshjeve që paraqiten në mes bashkëshortëve.

Seanca për pajtimin e bashkëshortëve është obligative, dhe as gjykata e as palët nuk mund të heqin dorë prej saj, përveç në rastet e parapara me ligj, ku seanca për pajtimin e bashkëshortëve nuk do të caktohet, edhe atë³⁸ nëse:

- *njëri prej bashkëshortëve është i paaftë për të gjykuar;*
- *njëri ose të dy bashkëshortët jetojnë në botën e jashtme;*
- *nëse është i panjohur vendbanimi ose vendqëndrimi i njërit nga bashkëshortët më tepër se 6 muaj dhe*
- *pas kundërpadisë për shkurorëzim, pa marre parasysh se kur ajo është parashtruar, tentimi për pajtimin e bashkëshortëve ka qenë i pasuksesshëm.*

Me Ligjin për familjen janë paraparë paraparë rastet në të cilat seancën për pajtimin e bashkëshortëve nuk e zbaton gjykata, por atë domosdoshmërisht e zbaton QPS, rastet e tilla janë: nëse bashkëshortët kanë fëmijë të mitur të përbashkët ose fëmijë ndaj të cilëve është vazhduar e drejta prindërore³⁹. Ndërsa, nëse bashkëshortët nuk kanë fëmijë të përbashkët të mitur ose fëmijë ndaj të cilëve u është vazhduar e drejta prindërore, seancën për pajtimin e bashkëshortëve e realizon gjykata, nëse e njëjta nuk e vlerëson se pajtimi është më mirë t'i besohet QPS⁴⁰.

Si arsye kryesore për të cilën parashihet kompetenca e QPS për zbatimin e seancës për pajtim, është aspirata për humanizmin sa më të madh të procedurës së shkurorëzimit si dhe puna interdisciplinare që e bën QPS. Në të vepron ekipi i përbërë prej ekspertëve si punëtorë social,

³⁷ Ndërmjetësimi familjar është term i ri që përdoren në vend të institutit juridiko familjar - pajtim i bashkëshortëve, i cili në vete përfshin edhe procedurat tjera të ofrimit të ndihmës profesionale në rastet e ndryshme të marrëdhënieve të rregulluara familjare, cili rekomandohet që të fillohet të aplikohet edhe nga shtetet tjera evropiane- sipas kornizës së Rekomandimeve të Këshillit të ministrave të Këshillit të Evropës nr.R (98) 1 për ndërmjetësim, gjendet edhe në <https://wcd.coe.int/com.instranet.InstraServlet?command=com.instranet.CmdBlobGet&InstranetImage=1153972&SecMode=1&DocId=450792&Usage=2>

³⁸ Nen 237, al 2, LF

³⁹ Nen 273, al 3, LF

⁴⁰ Nen 273, al 5, LF

juristë, psikologë dhe pedagogë. Ky është rol i qendrave të ekipuara mirë, sepse me një qasje të tillë komplekse dhe multidisiplinare bashkëshortëve u mundësohet njohja dhe kuptimi i vështirësive me të cilat ballafaqohen, dhe eventualisht pajtimi i tyre. Në rastet kur një gjë e tillë nuk është e mundur, ndihmohen bashkëshortët që të fitojnë pasqyrë sa më reale për sa u përket marrëdhënieve reciproke tyre, veçanërisht kur është fjala për fëmijët e përbashkët. Është evidente se procedurat tradicionale juridike nuk janë të përshtatshme për zgjidhjen e pyetjeve të ndjeshme në kontestet familjare dhe se seanca e pajtimit ose më mirë thënë ndërmjetësimi ofron qasje më konstruktive ndaj kësaj çështje. E njëjta gjë është paraparë edhe në dokumentin e Këshillit të Evropës⁴¹, me vlerësim se procedurat e tilla edhe në Evropën bashkëkohore janë pasqyrë e demokratizimit të përgjithshëm shoqëror i cili qytetarëve ua pranon aftësinë për vendosje të përgjegjshme dhe paqedashëse për fëmijët e vetë dhe për vete.⁴²

Gjykata pas pranimit të padisë për shkurorëzim, gjegjësisht të propozimit për shkurorëzim me marrëveshje të martesës, ka për detyrë në afat prej 8 ditëve, të dorëzojë lajmërim me shkrim deri tek QPS, me të dhëna për kohën e paraqitjes së procedurës për shkurorëzim, arsyet kryesore për të cilat kërkohet shkurorëzimi dhe të dhëna për fëmijët, ndërsa QPS është e obliguar që në afat prej tre muajve nga pranimi i lajmërimit ta përfundon seancën për pajtimin e bashkëshortëve⁴³.

Nga të dhënat me të cilat disponon QPS, mund të konkludohet se suksesi i seancave për pajtim të bashkëshortëve është tejet i vogël⁴⁴. Pajtimi më se tepërmi arrihet tek ata bashkëshort tek të cilët niveli i arsimimit është më i ulët (më së tepërmi me arsim fillor të kryer) si dhe gjendja ekonomike e të cilëve është më e vështirë. Bashkëshortët e tillë nuk janë në gjendje të përballohen me pasojat që i sjell shkurorëzimi, ose më mirë thënë “luksozin” që e mbart me vete shkurorëzimi, si p.sh pagimi i alimentacionit, ushqimi i fëmijëve, sipas nevojës edhe bashkëshortit të pasiguruar, me një fjalë ballafaqimi me gjithë grackat e jetës, por tash vetë, pa

⁴¹ *Rekomandim i Këshillit të ministrave të Këshillit të Evropës nr.R (98) për ndërmjetësimin*, gjendet edhe në <https://wcd.coe.int/com.instranet.InstraServlet?command=com.instranet.CmdBlobGet&InstranetImage=1153972&SecMode=1&DocId=450792&Usage=2>.

⁴² Mira Alinčić, Ana Bakarić, Dubravka Hrabar, Dijana Jakovac Lozić, Aleksandra Korać, *“Obiteljsko pravo”*, Zagreb, 2001, f. 113.

⁴³ Nen 237 al 4 LF

⁴⁴ Sipas të dhënave interne dhe jo zyrtare të QPS, në vitin 2009 QPS ka zbatuar 458 seanca për pajtim të bashkëshortëve, nga 1.072 kërkesa për shkurorëzim, prej të cilave kanë pasur sukses vetëm 49, që nuk është edhe 10 % nga kërkesat e paraqitura për shkurorëzim.

ndihmën e bashkëshortit tjetër, prandaj, faktori ekonomik dhe niveli i arsimit të bashkëshortëve më së tepërmi ndikojnë në faktin se a do të vije deri tek pajtimi ose jo.

Nëse bashkëshortët nuk kanë fëmijë të mitur ose fëmijë të cilëve u është vazhduar e drejta prindërore, procedurën për pajtimin e bashkëshortëve e zbaton gjykata, pos nëse nuk vlerëson se është më mirë që pajtimi t'i besohet QPS. Kur seancën për pajtimin e bashkëshortëve zbatohet nga ana e gjykatës, kryetari i trupit gjykues cakton seancë të posaçme. Seanca për pajtim mbahet vetëm në prani të kryetarit të kolegjit, pa prani të proçesverbalistit⁴⁵.

Sa u përket fëmijëve, gjatë zhvillimit të procedurës së shkurorëzimit, QPS ka mundësi që:

-të propozojë që gjykata të përcaktojë masa të përkohshme për dhënien e ushqimit fëmijëve të përbashkët të bashkëshortëve si dhe ruajtjen dhe edukimin e tyre⁴⁶

- të japë propozime të tjera lidhur me fëmijët, dhe të kontribujë mjete juridike lidhur me ato propozime, në bazë të autorizimeve nga neni 249 të LF-ës.

Qendra për punë sociale, pas tentimit për pajtimin e bashkëshortëve, nëse e vlerëson se një gjë e tillë nuk është e mundur, përpilon raport të cilin duhet t'ia dorëzojë gjykatës më së voni në afat prej tre muajve. Pas kalimit të këtij afati, por edhe më parë, në qoftë se i është dorëzuar raporti nga QPS, ose pas mbajtjes së seancës për pajtim para kryetarit të trupit gjykues, ai e cakton seancën kryesore dhe të paditurit ia dorëzon padinë për shkurorëzim duke ia bënë me dije për ditën dhe orën e mbajtjes së seancës kryesore⁴⁷.

Pas mbajtjes së seancës për pajtim të bashkëshortëve, fillohet gjegjësisht vazhdohet më tej me procedurën e shkurorëzimit dhe caktohet seanca kryesore.

⁴⁵ Nen 237, al 5, dhe nen 238, al 1,2 LF

⁴⁶ Nen 251, al 1, LF

⁴⁷ Nen 246, LF

1.6. Shqyrtimi kryesor

Pas dështimit të seancës së tentim pajtimit, gjykata cakton shqyrtimin kryesor. Në këtë fazë palët ndërgjyqësore qoftë personalisht qoftë përmes të autorizuarve të tyre paraqesin provat. Në këtë fazë gjykata ka rol aktiv, me crast ajo mund të aprovojë apo të refuzojë kërksen e palës për zgjidhjen e martsës. Bashkeëshorti paditës pretendon dhe provon para gjykatës se jetesa e përbashkët është bërë e pamundur, pra në këtë rast zgjidhja e martsës vjen si rezultat i cënimit të kushteve objektive dhe subjektive që i japin jëtë institutit të martsës.⁴⁸

Gjateë shqyrtimit kryesor gjykata me rastin e marjes së vendimit meritor, në radhë të parë duhet të ket parasysh interesat më të mira të fëmijëve të mitur, e jo të bashkëshortëve. Jo vetëm legjislacioni pozitiv vendor, por edhe Konventa Mbit të Drejtat e Fëmijëve (KDF) përfshin dispozita që kanë te bëjnë me gjykimin e cështjeve familjare. Neni 3 i Konventës parasheh se; në të gjitha veprimet që kanë te bejnë me fëmijët , të marra nga institucionet pivate apo publike të mirëqënies shoqërore, gjykatat, autoritetet administrative apo organet legjislative, interesat më të mira të fëmijëve do të jene konsideratë primare.⁴⁹

1.7. Marrja e aktgjykimit

Pas përfundimit të shqyrtimit kryesor, marrja e aktgjykimit është faza përfundimtare lidhur me procedurën e shkurorëzmit. Gjykata me aktgjykim mund ta aprovojë apo ta refuzojë kërkesën për shkurorëzim pa marë parasysh faktin se nësë është inicuar procedura me marveshje te përbashkët përkatësisht me padi me propozim apo padi të njëanshme. Sipas detyrës zyrtare, gjykata ka të drejtë të vendos për cështje lidhur me mbrojtjendhe kujsedin ndaj fëmijëve: se cilit prind do ti besohen fëmijët e përbashkët në ruajtje, , kujdes, për detyrimin e pagimit të ushqimit si de për kontaktin e fëmijës me prindërit. Kundër akgjykimit të shkallës së parë pala e pa kënaqur ka të drejtë në ankesë në afat brenda 15 ditëve nga dita e dorëzimit të aktgjykimit, lidhur me të cilën vendos gjykata e shkalës më të lartë.

⁴⁸ Arta Mnandro, E Drejta Familjare, Tirane 2009,f.315

⁴⁹ Nen 3 KOntenta Mbi te Drejtat e Fëmijwve.

1.8. Pasojat e shkurorëzimit së martesës ndahen në dy grupe

a. Pasojat personale juridike të zgjidhjes së martesës me shkurorëzim për bashkëshortët si:

- *Mbiemri*
- *Ndarja e pronës së përbashkët*
- *Kthimi i dhuratave*
- *Detyrimi i ushqimit*
- *E drejta e banesës*
- *E drejta e trashëgimit*

b. Pasoja juridike personale për fëmijët e përbashkët ose për fëmijë ndaj të birësuar ose për famijë ndaj të cilëve është vazdhuar e drejta prindërore.

a) Mbiemri - Me zgjidhjen e martesës, ndryshon gjendja civile e bashkëshortëve. Kjo gjendje ndryshon nga “i/e martuar” që ishte gjatë martesës, në “i/e shkurorëzuar” që bëhet pas zgjidhjes së martesës.⁵⁰ Zgjidhja e martesës ka për pasojë shuarjen e të drejtave dhe detyrimeve me karakter personal që ekzistonin deri më atëherë në mes bashkëshortëve për shkak të martesës.

Zgjidhja e martesës nëpërmjet shkurorëzimit nuk ndikon në mënyrë direkte në mbiemrin që e mbajnë bashkëshortët, gjegjësisht në mbiemrin e bashkëshortit i cili e ka marrë atë me lidhjen e martesës.⁵¹ Gjegjësisht, bëhet fjalë për mundësinë, bashkëshorti i cili e ka ndërruar mbiemrin gjatë lidhjes së martesës, me shuarjen e kësaj baze, ta mbaje mbiemrin bashkëshortor, ose që ta ktheje mbiemrin të cilin e ka pasur para lidhjes së martesës. Bashkëshorti i cili e ka mbajtur mbiemrin bashkëshortor pas shkurorëzimit, ka të drejt që ta mbaje atë edhe në rast se lidhën martesë të re, për arsye se ajo nuk është e ndaluar me dispozita juridike.⁵² ‘

b) Ndarja e pasurisë së përbashkët në mes bashkëshortëve- Si pasoj e shkurorëzimit të martesës në sferën e pasurisë, është ndarja e pasurisë së përbashkët nga ana e bashkëshortëve. Në Ligjin për pronësinë dhe të drejtat tjera sendore të RM-së, parashihet se bashkëshortët gjatë kohëzgjatjes së martesës dhe pas zgjedhjes së saj, me marrëveshje mund ta ndajnë pasurin e

⁵⁰ Valentina Zace vep, e cit, fq 101

⁵¹ Marija Draskic, Vepra e cituar, f.155.

⁵² Ljiljana Spiroviq Trpenovska, Vepra e cituar, f.136.

përbashkët. Me ndarjen e pasurisë së përbashkët të bashkëshortëve krijohet regjimi i pasurisë së ndarë (neni 47 al.1 dhe 2 i Ligjit për pronësinë dhe të drejtat tjera sendore, në tekstin e mëtutjeshëm LPDS).⁵³

Bashkëshortit të cilit i janë lënë për rritje dhe edukim fëmijët e përbashkët, i jepen në pronësi përpos pjesës së tij, edhe sendet të cilat u shërbejnë fëmijëve ose janë të dedikuara për përdorimin e tyre (neni 77, al.1 i LPDS).

c) E drejta në trashëgimi në mes ish -bashkëshortëve – Duke qenë se vetëm bashkëshortit i njihet e drejta ligjore e trashëgimisë së bashkëshortit tjetër, me zgjidhjen e martesës, kjo e drejtë pushon së ekzistuari. Pra, me zgjidhjen e martesës, pushon e drejta në trashëgimi në mes bashkëshortëve (neni 26, al.1 i LT).⁵⁴

Kjo që u tha më lart ka të bëjë vetëm me të drejtën në trashëgimi ligjore. Kur është fjala për trashëgimin testamentare, në ato raste e drejta në trashëgimi varet nga koha e përpilimit të testamentit. Testamenti e humb veprimin juridik, në qoftë se është përpiluar gjatë kohës së zgjatjes së bashkësisë martesore. Ndërsa, testamenti do të prodhojë veprim juridik, në qoftë se në të është e përmbajtur deklarata e testamentlënësit, se, bashkëshorti/ja e tij do të mbetet trashëgimtarë i/e tij, gjegjësisht nuk e humbën të drejtën në trashëgimi edhe në rast të zgjidhjes së martesës me shkurorëzim.⁵⁵ Praktika e ka dëshmuar se shumë të ralla janë rastet e trashëgimit testamentar pas zgjedhjes së martesës, gjë që nuk është edhe traditë e viseve tona.

c) Detyrimi për ushqim në mes bashkëshortëve - Në pajtim me dispozitat nga neni 3 i LF, sipas të cilit marrëdhëniet në familje bazohen në barazi, respektim të ndërsjellë, ndihmë dhe obligimin për ushqim reciprok si dhe mbrojtje të interesave të fëmijëve të mitur, nga neni 111 alineja 1 se dhënia e ushqimit është e drejtë dhe detyrim, në mes të tjerëve, edhe e personave të cilët jetojnë në bashkësi martesore ose jashtëmartesore dhe me dispozitën nga neni 185 i LF, janë rregulluar kushtet nën të cilat njëri bashkëshort ka të drejtë në ushqim nga bashkëshorti tjetër.

Bashkëshorti, i cili është pa mjete të mjaftueshme për të jetuar dhe që është i paaftë për punë ose është i papunë pa fajin e vetë, ka të drejtë në ushqim nga ana e bashkëshortit të vetë në

⁵³ Ligji për pronësinë dhe të drejtat tjera sendore,(Gazeta zyrtare e RM-së, nr.18/01)

⁵⁴ Ligji për trashëgimi,(Gazeta zyrtare nr.47/96.)

⁵⁵ Ljiljana Spiroviq Trpenovska, Vepra e cituar, f.137.

proporcion me mundësit e tij (neni 185 al. 1 i LF). Bashkëshorti nevojtar ka të drejtë që të kërkojë që me anë të aktgjykimit me të cilin shkurorezohet martesë të gjykohej një shumë e caktuar e të hollave në emër të ushqimit në barrë të bashkëshortit tjetër.

Me vetë faktin e lidhjes së martesës në momentin kur bashkëshortët regjistrohen në librin amë të të martuarve (në Republikën e Maqedonisë) ose në regjistra tjerë përkatës (në shtetet tjera), merret mbi vete obligimi reciprok për ushqim në kuadër të bashkësisë martesore. Që detyrimi për ushqim, të vazhdojë edhe pas pushimit të martesës nevojitet që plotësohen kushtet e parapara në ligj, gjegjësisht bashkëshorti nevojtar të mos ketë mjete të mjaftueshme për jetesë, si dhe njëkohësisht të mos jetë i aftë që ato vetë ti fitojë⁵⁶, të paraqesë kërkesë për ushqim, ndërsa bashkëshorti tjetër të jetë i aftë financiarisht që ta plotësojë kërkesën e tillë “ në pajtim me mundësit e veta”. Praktika gjyqësore, ka treguar se, gjykata çdo here para marrjes së vendimit lidhur me çështjen e ushqit në mes bashkëshortëve i vlerëson edhe rrethanat tjera të cilat potencialisht mund të ndikojnë, nga njëra anë në gjendjen materiale të kërkuarit të ushqimit, dhe nga ana tjetër në gjendjen materiale të pranuesit potencial të ushqimit. Sa i përket bashkëshortit i cili duhet të japë ushqim, duhet të ketë mundësi që ta japë atë, që do të thotë se atë nuk duhet ta bëjë në dëm të ekzistencës së vetë.

Detyrimi për ushqim të bashkëshortit të pasiguruar caktohet për një kohë jo më të gjatë se 5 vjet pas zgjidhjes së martesës (neni 189 al. 1 i LF-ës). Por, ligji parasheh situata të caktuara në të cilët bën lëshime sa i përket kësaj rregulle. Detyrimi ushqimor pushon para afatit të përcaktuar në ligj, kur pushojnë kushtet për të cilat është dhënë ushqimi, kur do të kalojë koha për të cilën është paraparë ushqimi dhe kur bashkëshorti i mëparshëm i cili e pranon ushqimin do të lidhë martesë të re, gjegjësisht do të hyjë në bashkësi jashtëmartesore (neni 191 i LF-ës).

Kur është fjala për fëmijët, qendra për punë sociale në kuadër të ingerencave të veta e përfshin edhe mbrojtjen e të drejtave dhe interesave të fëmijëve të mitur, sa i përket sigurimit të ushqimit për ta, edhe në këtë rast ajo paraqitet në atë rol, pasi që është i autorizuar për iniciimin e kontestit për sigurimin e ushqimit ose rritjen e tij. Këtë lloj autorizimi QPS e ka çdo herë kur prindi tek i cili gjendet fëmija për rritje dhe edukim nuk e shfrytëzon atë të drejtë pa arsye të justifikuar.

⁵⁶ Nen 185, al1, LF -Bashkëshorti nuk është i aftë që vetë të fitojë mjete për jetesë në qoftë se është i paaftë për punë ose është pa punë mirëpo jo me fajin e vetë”

ç) Kthimi i dhuratave – Dhuratat e dhëna ndonjërit nga bashkëshortët gjatë jetës së tyre bashkëshortore, hynë në pasurin e tyre të veçant. Në këtë rast, kur është fjala kthimin e dhuratave pas zgjidhjes së martesës, parashtrohet pyetja se si duhet të konsiderohen dhuratat si pasuri e përbashkët ose e veçant dhe se a duhet të kthehen ato pas zgjidhjes së martesës. Ligji për pronësinë dhe të drejtat tjera sendore i RM-ës parashih se: “Dhuratat të cilat bashkëshortët ia kanë dhënë njëri tjetrit para lidhjes së martesës ose gjatë martesës, nuk kthehen” (neni 80). Në praktiken gjyqësore, dhuratat konsiderohen si pasuri e veçant e bashkëshortëve dhe ata nuk kthehen,⁵⁷ që njëkohësisht është edhe qëndrim i Gjykatës Supreme të RM.

d) E drejta e përdorimit të banesës familjare - Si një nga pyetjet e rëndësishme për të cilat bashkëshortët duhet të merën vesh është edhe çështja e përdorimit të banesës së përbashkët familjare. Mirëpo, sa i përket kësaj pyetjeje, në rregullativën juridike çështja e kësaj nuk është rregulluar. Në qoftë se ish-bashkëshortët nuk arrin marrëveshje për përdorimin e banesës së tyre të përbashkët, në atë rast vendimin për përdorimin e banesës familjare do ta marre gjykata duke i pasur parasysh faktin se cilit prind i janë lënë fëmijët për rritje dhe edukim. Në praktik, në shumicën e rasteve ndodhë që fëmijët ti lehen nënës për rritje dhe edukim, për këtë arsye edhe ndodhë që banesa ti lehet për përdorim bashkëshortes, dhe kjo bëhet qoftë me marrëveshje të bashkëshortëve ose me vendim të gjykatës.

Fëmijët me rastin e zgjidhjes së martesës i besohen: Vetëm njëri prind në ruajtje, mbajtjen dhe edukimin ndahen dhe dy prindërve i besohen fëmijët e përbashkët ose fëmijët besohen një personi tretë apo institucioni tjetër.⁵⁸

Nëse pas zgjidhjes së martesës, cilësia e bashkëshortëve kthehet në ish bashkëshort, cilësia e prindit në raport me fëmijët e tyre nuk ndryshon. Zgjidhja e martesës nuk prek të drejtat dhe detyrimet që kanë prindërit ndaj fëmijëve të tyre. Prindërit vazhdojnë të kenë drejta dhe detyrime të kujdesen për rritjen, zhvillimin dhe edukimin e fëmijëve të tyre.⁵⁹

Bashkëshortët mundet që me marrëveshje të përbashkët të zgjidhin çështjen e ndarjes së fëmijëve. Nëse nuk ekziston marrëveshja midis tyre lidhur me përkujdesjen e fëmijëve atëherë,

⁵⁷ Aktgjykim i Gjykatës themelore Shkup 2-Shkup, XV.II.nr.2798/07, nga 25.12.2008

⁵⁸ <https://dspace.aab-edu.net/bitstream/handle/123456789/722/13282c07-c6f8-41bb-a41e-fa7a29da68bd.pdf?sequence=3&isAlloëed=y>

⁵⁹ Arta Manderi Balili, Vjollca Meçaj, Tefta Zaka, Arjana Fullani, Vepra e cituar, f.445.

gjykata *ex officio* sjell vendimin për ruajtjen, edukimin dhe ushqimin e fëmijëve, mirëpo, gjithmonë duke e marrë mendimin paraprakë të Qendrës për punë sociale, e cila i shqyrton të gjitha rrethanat të cilat mund të ndikojnë në rritjen dhe edukimin e mirë të fëmijëve, dhe duke e pasur parasysh interesin më të mirë të tyre, vendos se cilit prind do ti lehen fëmijët për rritje, ushqim dhe edukim, ndërkaq nëse ruajtja dhe edukimi i fëmijëve nga prindërit e tyre është në kundërshtim me interesin e tyre, atëherë fëmijët ngelin nën përkujdesjen e organit të kujdestarisë.

Edhe pse të ndarë nga fëmijët, çiftet vazhdojnë të jenë prindërit e tyre përkundër moskoordinimeve që kanë ndërmjet vete për çështje tjera jetësore, mirëpo, në çdo vendimmarrje të tyre në prioritet duhet të kenë interesin më lartë të fëmijëve. Pasojat personale të shkurorëzimit duhet të ndikojnë drejtpërdrejtë tek ish-bashkëshortët, e assesi tek fëmijët, sepse ata nuk janë aspak fajtorë për situatën jetësore që ua krijojnë prindërit.

KAPITULLI I DYTE
TUTORIA DHE KUJDESTARIA E FËMIJËVE PAS
SHKURORËZIMIT

1. Kuptimi i së drejtës së kujdestarisë

Kujdestaria është një nga format e mbrojtjes sociale, sipas të cilës shteti u siguron mbrojtje të vecantë të miturve pa përkujdesje prindërore, si dhe personave të tjerë të cilët për shkak të paaftësisë ose për arsye të tjera, nuk janë në gjendje të kujdesen për të drejtat dhe interesat e tyre.⁶⁰ Gjatë kohës kujdestaria është realizuar në kuadër të familjes si një institucion familjar. Familja me tjerash ka pasur për detyrë të kujdeset për të gjithë anëtarët e saj të cilët kanë pasur nevojë për kujdes të tillë. Vetëm kur një person nuk ka pasur familje, kujdesin për të e ka ndërmarrë shteti. Me zhvillimin e shoqërisë familja ndryshon, disa nga funksionet e familjes ndryshohen, zvogëlohen disa prej tyre edhe kanë rënë, kështu që disa funksione të veçanta në lidhje me kujdesin e të miturve pa prindër dhe personat tjerë të cilët nuk janë të paaftë për një jetë të pavarur i ndërmerr shteti nëpërmjet institucioneve të tij shtetërore. Gjithë ky riedukim i familjeve dhe institucionit të kujdestarisë është zhvilluar gradualisht dhe në shkallë të ndryshme.⁶¹

Kujdestaria është një institucion, mjaft i lashtë i së drejtës. Rregullat e para juridike të këtij institucion i gjejmë qysh në Ligjin XII tabelave. Ndonëse ky institucion juridik gjatë evolimit historik ka pësuar ndryshime të rëndësishme, qëllimi i tij themelor si: mbrojtja e personave që nuk janë në gjendje të kujdesen për vetvete, interesat pasurore dhe të drejtat e interesit të tyre ka mbetur pothuajse gjithmonë i pandryshuar. Në bazë të dispozitave ligjore pozitive institucionet publike kanë detyrë të sigurojnë mbrojtje të veçantë fëmijëve të mitur pa përkujdesje prindërore, personave madhorë pa zotësi veprimi dhe personave të tjerë. Të miturit për shkak të pamaturisë fizike dhe mendore kanë nevojë për një përkujdesje dhe mbrojtje të veçantë të të drejtave të tyre. Janë prindërit që nëpërmjet ushtrimit të përgjegjësisë prindërore realizojnë të drejtat dhe përmbushin detyrimet e tyre, derisa ata të arrijnë moshën madhore, moshë kur ata mbajnë përgjegjësi të plotë për veprimet.

Sipas dispozitave të Ligjit për Familje të Republikës së Maqedonisë thuhet se fëmijët e mitur vendosen në kujdestari dhe gëzojnë mbrojtje të veçantë nga shteti kur prindërit e tyre janë në

⁶⁰ Ruzhdi Berisha vep, e cit, fq. 519

⁶¹ Makedon Sllavkoski, Puna në zyrë për vitin III lëndë zgjedhore dhe e rregulltë, drejtimi ekonomik – juridik dhe tregtar, teknik juridik, Shkup, 2013, fq. 57

pamundësi për të ushtruar përgjegjësinë prindërore, për shkak se të dy prindërit kanë vdekur ose nuk njihen, janë shpallur si të zhdukur, u është hequr përgjegjësia prindërore ose u është hequr zotësia për të vepruar, si dhe për çdo shkak tjetër të pranuar nga gjykata.

Gjykatë kompetente për vendosjen në kujdestari të të miturit është ajo e vendbanimit ose vendqëndrimit të të miturit. Familja kujdestare është një familje alternative, e vendosur nga gjykata, për t'i ofruar fëmijës një mjedis familjar, kushte për mirërritje, përkujdesje fizike dhe mbështetje emocionale. Evidentimi i familjeve kujdestare është përgjegjësi e sektorit të ndihmës dhe shërbimit social pranë bashkisë ose komunës ku banon i mituri, e cila realizohet me firmosjen e një deklarate gatishmërie nga familja për të marrë fëmijën në kujdestari. Numri i fëmijëve që i jepen në kujdestari një familjeje kujdestare duhet të jetë i kufizuar, duke u dhënë prioritet në këtë vendosje fëmijëve që janë vëllezër dhe motra me njëri-tjetrin.

Shikuar historikisht tutoria dhe kujdestaria janë institucione juridike të lidhura shumë ngushtë me çështjen e zotësisë së veprimit të personave *sui juris*. Duke marrë parasysh rregullat mbi organizimin e pushtetit familjar dhe për shkak të një vargu rrethanash natyrore (mosha, gjinia, cilësitë, psikike, morale dhe fizike), problemi i zotësisë së veprimit shfaqet tek ata persona të cilët për çfardo arsye nuk jetojnë nën patria potestas, apo të cilëve u njëhej statusi i personave *sui juris*, kur gjendeshin në rrethana të tilla sa nuk mund të pritej që në mënyrë të arsyeshme të përdorin pavarësisht të drejtat e njohura. Me fjale të tjera në të drejtën romake ekzistonin dy institucione të cilat kishin për qëllim të plotësojnë mungesën e zotësisë së veprimit të personat pa aftësi.

Kujdestaria – ishte institucion me të cilin plotësohej mungesa e zotësisë së veprimit të personat të cilët nga vetë natyra duhet të kishin zotësi të plotë veprimi, mirëpo nuk ishte ashtu për shkak të të metave personale.

Tutoria – ishte institucion me të cilit plotësohet mungesa e zotësisë së veprimit të kategorive të tëra të personave që për shkak të moshës osë gjinisë nuk ishin në gjendje të dilnin në komunikimin juridik.⁶²

Qëllimi i kujdestarisë është mbojtja e personalitetit, pasurisë, të drejtave dhe interesave të personave të mitur dhe personave të tjerë, të cilit nuk janë në gjendje të kujdesen për veten e tyre. Organi i kujdestarisë veprimtarinë e vetë e kryen në dy mënyra:

- a) *Në mënyrë të drejtpërdrejtë, kur vet organi i kujdestarisë pa pjesëmarrjen e personave të tjerë i kryen detyrat e kujdestarit dhe*
- b) *Në mënyrë të thërthortë kur organi i kujdestarisë e emërton një kujdestar për kryerjen e punëve dhe detyrave të kujdestarit.*

Siç dihet kujdestarët e parë dhe natyrorë të fëmijëve dhe të përsoneve pa zotësi të plotë për të vepruar janë prindërit e tyre dhe kjo lloj kujdestarie është ajo që hasim rëndom në jetën e përditshme. Mungesa e prindërve ose pamundësia e tyre për të ushtruar kujdesin ndaj fëmijëve, pavarësisht nga shkaqet ka imponuar çdo shoqëri të përcaktojë zgjidhje alternative me qëllim që si fëmijët të mitur ashtu edhe personave pa zotësi të plotë për të vepruar tu krijohen kushte për tëgëzuar kujdesin e duhur. Tutotia dhe kujdestaria ka gjetur trajtim të gjërë. Kujdestaria ishte institut për vendosjen e kujdesit mbi personat që u ishte hequr ose kufizuar zotësia për të vepruar, ndërsa tutoria si institut kishte për qëllim të siguronte ushqimin e kujdesit dhe të mbrojtjes së të drejtave e interesave të fëmijëve të mitur, prindërit e të cilave ose kishin vdekur ose ishin në pamundësi të ushtronin të drejtën prindërore.

⁶² Ivo Puhani, E drejta romake, Prishtinë, 1988, fq.27

1.1. Të drejtat prindërore dhe kujdestaria

Për të bërë më të lehtë të kuptuarit e karakteristikave dhe parimeve themelore të kujdestarisë në legjislacionin tone është e nevojshme të dime rrënjët e kësaj të drejte se kur është paraqitur dhe cilët janë fillimet e saj. Nëse ndonjë person nuk ka zotësi veprimi apo ajo për shkaqe të ndryshme i është kufizuar apo pezulluar, atëherë paraqitet nevoja që atë person ta përfaqësojë dikush, që ka të bëjë me veprimet juridike dhe veprimet tjera të karakterit jojuridik (p.sh. përfaqësimi si plotësim për aftësinë e veprimit). Ajo mungesë apo pamundësi e të shprehurit të “vullnetit” plotësohet me përfaqësim deri tek i cili vihet në bazë të dispozitave ligjore. Disa forma ligjore të përfaqësimit janë të bazuara në rregullat natyrore apo edhe në rregullat shoqërore të cilat janë të pranuara gjithkund, e kjo është rasti me të drejtën prindërore të cilin mund ta realizojnë prindërit, kujdestarët, adoptuesit, si dhe entet kompetente të cilat kujdesen për personat që nuk kanë zotësi veprimi (qendrat për punë sociale). Prindërit janë përfaqësues natyror të fëmijëve të vet në të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me interesat e tyre sidomos ato pronësore.⁶³

Kjo do të mund të konsiderohej edhe si rregull që del nga të kuptuarit e të drejtës natyrore apo natyrës së gjërave. Këtu nuk është i nevojshëm akti i posaçëm i pushtetit shtetëror për t'i hyrë marrëdhënies së përfaqësimit.

Të drejtat dhe detyrat prindërore e bëjnë të drejtën prindërore në lidhje me kujdesin e prindërore për fëmijët e tij të mitur. Në raporte midis prindërore dhe fëmijëve në një plan është vendosur mbrotja e interesave të fëmijëve të mitur, kujdes për personalitetin e tyre për interes dhe të drejtat e tyre për ndërgjegjshmërinë dhe aftësimin e tyre për jetë, të bëhen qytetarë të dobishëm të komunitetit dhe për ndërtimin e raporteve të shëndosha në familje dhe për këtë mbajnë përgjegjësi të plotë. E ëma dhe i ati në të drejtat ndaj fëmijëve të cilët me marrëveshje e kryejnë të drejtën prindërore të barabartë.

Në pjesën e dytë të Ligjit për Familje të Republikës së Maqedonisë, është parashtruar një sferë e veçantë ku hartohet të drejtat dhe obligimet e prindërore dhe fëmijëve. Neni 46 i këtij ligji

⁶³ Dr. sc Zenaid Xhelmo, Hyrje në Drejtësi, Sarajevë/Prishtinë, 2006, fq.160

flet se prindërit kanë të drejtë dhe obligim t'i mbajnë fëmijët e tyre të kujdesen për jetën dhe shëndetin e tyre ti përgatitin për jetë e punë të pavarur të kujdesen për edukimin e tyre, shkollimin dhe aftësimin profesional të tyre. Fëmija ka të drejtë në mbajten nga prindërit e tij të jetë i përkujdesur të mbrohet jeta dhe shëndeti i tij, të aftësohet për jetë dhe punë të pavarur, ti sigurohen kushtet e familjes.

Sipas nenit 47 të LF, fëmijët e mitur kanë të drejtë të jetojnë me prindërit e tyre. Fëmijët e mitur mund të jetojnë ndaras nga prindërit e tyre, vetëm atëherë kur ajo paraqet interes të drejtëpërdrejtë për fëmijët ose kur kjo paraqet interes të përbashkët për fëmijët dhe për prindërit. Paragrafi i radhës flet që fëmijë të mbajnë raporte personale dhe kontakte të drejtëpërdrejta me prindin me të cilin nuk bashkëjetojnë. Prindi me të cilin nuk jeton fëmija ka të drejtë dhe obligim të mbajë raporte personale dhe kontakte të drejtëpërdrejta me fëmijën e tyre. Fëmijët e mitur kanë të drejtë të mbajnë kontakte të drejtëpërdrejta me prindërit dhe të afërmit e tjerë të prindëve që kanë ndëruar jetë i cili është marrë e drejta prindërore se nga shkaqet e tjera është i penguar të ushtrojë të drejtën prindërore.

1.2. Organi i kujdestarisë

Punët dhe detyrat e organit të kujdestarisë janë të shumta e të ndërlikuara. Qëllimi i kujdestarisë është mbrojtja e personalitetit, e pasurisë e të drejtave dhe interesave të personave të mitur dhe të personave të tjerë të cilët nuk janë në gjendje të përkujdesen për veten.⁶⁴ Organi i kujdestarisë, punët nga veprimtaria e vet i kryen nëdy mënyra: të drejtëpërdrejtë dhe të tërthortë. Qëhen të drejtëpërdrejta ato punë të cilat organi i kujdestarisë i kryen vetë në mënyrë të drejtëpërdrejtë pra pa pjesëmarrjen e personave të tjerë. Për këtë mënyrë të kryerjes së kujdestarisë, organi i kujdestarisë përcaktohet atëherë kur nuk mund të gjejë dhe të caktojë persona të përshtatshëm për ti emërtuar si kujdestarë. Të miturit për shkak të pamaturisë fizike dhe mendore kanë nevojë për një përkujdesje dhe mbrojtje të veçantë të të drejtave të tyre. Janë

⁶⁴ Santhipi Begeja, vepër e cituar, fq.309

prindërit që nëpërmjet ushtrimit të përgjegjësisë prindërore realizojnë të drejtat dhe përmbushin detyrimet e tyre, derisa ata të arrijnë moshën madhore, moshë kur ata mbajnë përgjegjësi të plotë për veprimet.⁶⁵

Por ka raste kur të miturit mbeten jashtë këtij përkujdesi për faktorë natyrale, sociale apo ligjore. Mungesa e përgjegjësisë së të miturve në këto kushte ka detyruar ligjvënësin të kërkojë zgjidhje alternative për mbrojtjen e të drejtave të tyre. Kujdestaria është një ndër alternativat ligjore për të miturit jashtë përkujdesit prindëror për t'u rritur pranë një mjedisi familjar, nën kujdestarinë e një kujdestari, familje kujdestare apo institucioni publik apo privat.

Kur duhet të vendosen të miturit në kujdestari?

Ligji I Familjes të R. Maqedonisë parashikon se në kujdestari do të vendoset personi i mitur pa përkujdes prindëror dhe ato janë rastet kur fëmija prindërit e të cilit nuk janë gjallë, të cilët janë zhdukur, të panjohur, apo janë me banim të panjohur më shumë se një vit dhe fëmija prindërit e të cilit pa marrë parasysh arsyet nuk i kryejnë perkohësisht ato përherë të drejtat dhe detyrimet e tyre prindërore.

a) Kujdestaria e fëmijës në rast shkurorëzimi

Qendrimi i femijeve pas një shkurorëzimi është një çështje shumë e rëndësishme, në shumë raste proceset e shkurorëzimit zgjasin me muaj të tere me qëllim që gjykata të marrë vendimin përfundimtar me korekt për të mirën e fëmijëve.

Gjykata gjatë procedurës së shkurorëzimit, në rastet kur bashkëshortët kanë fëmijë të përbashkët, shqyrton njëkohësisht edhe çështjen se kujt do t'i besojë fëmijët dhe kjo gjë duhet të vendoset me aktgjykimin me të cilin vendoset edhe zgjidhja e martesës. Në rast se prindërit nuk merren vesh se kujt i duhen besuar fëmijët, atëherë gjykata ka për detyrë të vendosë zyrtarisht se cilit nga prindërit i duhen besuar fëmijët. Gjykata, para së të marrë vendimin se cilit nga prindërit i duhen besuar fëmijët, duhet të marrë mendimin dhe propozimin e Organit të Kujdestarisë.

⁶⁵ Zimmerman, J., McGarrah, N. A., Ally, G. A., Hess, A. K., Benjamin, G. A. H., Gollan, J. K., & Kaser-Bond, N. (2009). Ethical and professional considerations in divorce and child custody cases. *Professional Psychology: Research and Practice*, 40, 539-54

Organi i Kujdestarisë shqyrton të gjitha rrethanat, që janë me rëndësi për zhvillimin e drejtë psikik dhe fizik, si edhe për edukimin e drejtë të fëmijës, siç janë: nevojat emocionale të fëmijëve, dëshira e fëmijës nëse i ka mbushur dhjetë vjet, mosha e fëmijës, gjendjen shëndetësore të fëmijës dhe të prindit, si edhe vetitë e ndryshme të prindërve⁶⁶.

Nëse prindërit nuk janë marrë vesh për rastin e përmendur më sipër ose nëse marrëveshja e tyre nuk iu përgjigjet interesave të fëmijëve, gjykata, pasi të marrë mendimin dhe propozimin e Organit të Kujdestarisë dhe të hetojë të gjitha rrethanat, do të vendosë ose që të gjithë fëmijët të mbeten për ruajtje dhe edukim te njëri prind, ose që disa të mbesin te nëna, kurse disa tek babai, ose të gjithë apo disa fëmijë t'i besohen ndonjë personi tjetër. Gjithashtu, nëse prindi, që ushtron kujdesin prindëror, pengon kontaktet personale të fëmijës me prindin tjetër, atëherë gjykata do të rregullojë me aktgjykim edhe mënyrën e mbajtjes së kontakteve personale të fëmijës me prindin, që nuk ushtron kujdesin prindëror, nëse vlerësimi i të gjitha rrethanave të rastit tregon se kjo është e domosdoshme për mbrojtjen e fëmijës. Gjikata, me kërkesën e njërit prind ose të Organit të Kujdestarisë, ndryshon edhe vendimin mbi kujdestarinë, nëse këtë gjë e kërkojnë rrethanat e ndryshuara. Gjithsesi, mendimi i fëmijës, që është i aftë të shprehë pikëpamjet e tij, do të merret parasysh nga gjykata në çdo procedurë që lidhet me të, ndërkohë mendimit të tij i jepet pesha e duhur në pajtim me moshën dhe aftësinë e tij për të kuptuar. Prezumohet se është më mirë për fëmijët që të jetojnë me prindërit e tyre natyror, me përjashtim kur mirëqenia e fëmijëve kërkon ndryshe⁶⁷ Në të gjitha procedurat e përmendura më lart, gjykata duhet të ketë në konsideratë parësore interesin më të mirë të të miturit, i cili gjen zbatim edhe përmes zgjidhjes së shpejtë e pa vonesa të këtyre problemeve, pa zvarritje nga ana e gjykatës.

⁶⁶ Oruçi, Gani, vepër e cituar, f. 107.

⁶⁷ Arta Mandro, vep. e cituar, fq.334.

KAPITULLI I TRETË

METODOLOGJIA

1. Statistika e lidhjeve të martesës dhe shkurorëzimet në Republikën e Maqedonisë gjatë vitit 2016.⁶⁸

Martesa është institucion i rëndësishëm i së drejtës familjare, dhe paraqet marrëdhënie të jetës së përbashkët e të vazhdueshme midis një buri dhe një gruaje, ndërkaq në disa shtete edhe marrëdhënie midis dy personave me gjini të njëjtë (në shtete të cilët kanë të legalizuar martesën midis personave me gjini të njëjtë). Të gjitha legjislacionet nacionale japin definicionin e institucionit të martesës- Martesa është bashkësi jetësore e burrit dhe gruas e rregulluar me ligj në të cilën realizohen interesat e bashkëshortëve, familjes dhe shoqërisë. Marrëdhëniet në mes bashkëshortëve themelohen e vendim të lirë të burrit dhe gruas për të lidhur martesë, në barazinë ndërmjet tyre, respektim të ndërsjellët dhe ndihmës reciproke (neni 6 i Ligjit mbi familjen të RM-së Gazeta Zyrtare e RM-së nr.157/2008.). Barazia e bashkëshortëve si në rastin e lidhjes së martesës, gjatë martesës si dhe në rast shkurorëzimi garantohet edhe me dokumentin më të rëndësishëm ndërkombëtarë- Deklaratën Universale të të drejtave të njeriut (neni 16.al.1). Siç e cekta edhe më lartë, martesa është marrëdhënie e vazhdueshme por jo e përhershme sepse e njëjta mund edhe të zgjidhet me vdekjen e njërit nga bashkëshortët, me shpalljen e njërit nga bashkëshortët e zhdukur për të vdekur, me anulimin e martesës dhe me shkurorëzimin e saj.

Sipas të dhënave të Entit Shtetëror të Statistikës, numri i martesave të lidhura gjatë vitit 2016 krahasuar me vitin paraprak është ulur me 7.0% dhe arrin në nurmin e 13.199 martesave. Numri i shkurorëzimeve në vitin 2016 është ulur në krahasim me 2015, për 9.8% dhe arrin në 1.985 numri i shkurorëzimeve. Në Republikën e Maqedonisë sipas të dhënave statistikore nga Enti shtetëror për statistikë, numri i shkurorëzimeve 6-7 viteve të fundit vazhdimisht është në rritje. Në vitin 2003 janë regjistruar shkurorëzimi i 14.402 martesave dhe ka pasur 1.405 shkurorëzime; në vitin 2004 – 14.073 shkurorëzime dhe 1.645 shkurorëzime; në vitin 2005- 14.500 shkurorëzime dhe 1.552 shkurorëzime; në vitin 2006- 14.908 shkurorëzime dhe 1.475 shkurorëzime; në vitin 2007- 15. 490 shkurorëzime dhe 1.417 shkurorëzime. Ndërkaq sipas të dhënave të fundit statistikore (16.06.2009) gjatë vitit 2008, kemi zvogëlimin e numrit të shkurorëzimeve dhe numrit të shkurorëzimeve. Në krahasim me vitin 2007, lidhja e martesave në vitin 2008 është zvogëluar për 5.1 % d.m.th janë lidhur 14.695 martesa. Gjatë vitit 2008 më tepër martesa janë lidhur në

⁶⁸ <http://www.stat.gov.mk/pdf/2017/2.1.17.13.pdf>

muajin gusht (13.1%), ndërkah më pak martesë në muajin prill (4.8%). Mosha mesatare gjatë lidhjes së martesës së parë është 24.7 vjet për femrën dhe 27.7 për mashkullin. Statistikat japin rezultatin se numri i shkurorëzimeve në vitin 2008 (1.209) është 14.7 % më i ulët se në vitin 2007. Sa i përket muajve, më tepër shkurorëzime janë regjistruar në muajin dhjetor (11.4%), më pak në muajin gusht (2.5%).⁶⁹



Tabela.Shkurorëzimet në bazë të muajve

Година	Вкупно Total	Месеци / Months												Year
		I	II	III	IV	V	VI	VII	VIII	IX	X	XI	XII	
2015	100.0	6.5	6.2	4.9	8.5	9.6	8.3	9.5	13.0	9.1	9.1	7.8	7.5	2015
2016	100.0	7.0	7.1	6.9	4.8	10.6	8.8	9.3	13.0	10.4	8.3	6.5	7.3	2016

Pak martesë 39 ose 2.0% e tyre gjatë këtij viti janë ndarë më së paku janë ndarë në qershor kurse në 245 më së shumti janë ndarë në muajin mars reth 12.3%

⁶⁹ Të dhënat janë marrë nga Enti Shtetëror Statistikor i RM-së, Shkup, 16.06.2009, Nr. 2.1.9.17

	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016- 2017
Padi të ngritura, nga ana e Burrit.	9	2	8	5	10	11	10	15	20
Padi të ngritura, nga ana e Gruas.	4	8	4	5	12	32	19	32	32

Sa është numri i rasteve ku Gjykata ka vendosur që kujdestarinë e fëmijëve t’ia lejoj njerit nga prindërve përgjatë periudhës 10 vjeçare në Praktikën Gjygsore në Dibër?

	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016/2017
Numri i rasteve	8	4	8	10	7	10	10	10	10

Sa është numri i rasteve për shkurorëzimet në të cilat është vendosur që kujdestaria e fëmijëve tu jepet prindërve?

	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016/2017
Padi të ngritura nga ana burrit	2	2	5	4	8	2	3	3	3
Padi të ngritura nga ana e gruas	1	4	5	4	2	1	5	5	4

Numri i Rasteve të shkurorëzimeve të sjellura nga ana e Gjykatës – në bazë të marrëveshjes për kujdestarinë e fëmijëve nga ana e njërit prind.

	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016/2017
Marrëveshja e prindërve për kujdestarinë e fëmijëve tek një prindër.	1	1	2	0	2	3	2	2	3

Numri i Rasteve të shkurorëzimeve të sjellura nga ana e Gjykatës – në bazë të padisë nga ana e njërit prind.

	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016/2017
Me padi nga ana e njërit prind	6	4	8	2	7	8	8	8	7

Sa është numri i rasteve (lëndëve) ku Gjykata e Rajonit të Dibrës i aka dorëzuar fëmijët nënës / babait?

	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016/2017
Nëna	7	1	4	5	4	5	7	7	9
Babai	4	2	1	3	0	1	1	2	3

Në sa raste me kërkesë nga Gjykata, ka marrë pjesë ekipi i qendrës sociale për mbrojtjen e fëmijëve?

	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016/2017
Me kërkesë të Gjykatës	2	5	8	5	4	8	10	10	10
Me kërkesë të Qendrës sociale	/	/	/	/	/	/	/	/	/

2. REZULTATET E HULUMTIMIT

Anketa

Anketa është zhvilluar në qytetin e Dibrës ku janë të përfshirë persona me shkollim fillore të mesëm dhe të lartë të grupmoshave të ndryshme. Numri i të anketuarëve 150 vetë prej të cilëve 90 janë të gjinisi mashkullore, kurse 60 janë të gjinisë femërore. Në anketë janë parashtruar gjithësej 14 pyetje me nga disa mundësi për tu përgjigjur në mënyrë të të anketuarëve të kenë më të lehtë të përgjigjen dhe të shprehin mendimin e tyre në lidhje me pozitën e kujdestarisë dhe shkurorëzimi në rajonin e Dibrës.

Anketa përmban këto të dhëna	Numri i përgjithsëhm i të anketuarëve – 150 vetë
Gjinia	90 meshkuj, 60 femra
Grupmosha	Nga 22-50 vjeç
Niveli i arsmit	Të mesëm dhe të lartë
Vendbanimi	Dibër

Anketa përmban këto pyetje:

1. A jeni aktualisht e martuar ose bashkëjetoni me një burë / grua?

a) Po, aktualisht e martuar

b) Po, bashkëjetoj më një burrë

c) Jo, nuk jam në asnjë lidhje

2. Cila është statusi juaj martesor?

a) I martuar

b) Shkurorëzuar

c) Beqare / beqare

3. Cila është arsyeja kryesore e shkurorëzimit në rajonin e Dibrës?

a) Problem financiare

b) Dhunë

c) Tradhëtia

4. Kur çiftet vendosin që të ndahen, si e konsiderojnë çështjen e fëmijëve?

a) Kujdestari

b) Mbështetje fëmijërore

c) Adoptim

5. Kush më së shumti vuan pas shkurorëzimit?

a) Burri

b) Gruaja

c) Fëmijët

6. Çfar efekti ka shkurorëzimi tek fëmijët?


a) Hyrje në krim
b) Bëhen të pavarur
c) Fillojnë me duhanpirjen
d) Aftësi të dobëta sociale
7. Bashkëshorti juaj, a u ndihmon financiarisht me të holla për fëmijën?
a) Po, më ndihmon
b) Jo, nuk më ndihmon
c) Ndonjë muaj kemi problem financiare
8. A ka ndodhur ndonjë rast, kur bashkëshorti juaj u ka kërcnuar juve, ose fëmijëve tuaj për dëmtim?
a) Po
b) Jo
c) Ndonjëherë
9. A jeni shqetësuar për sigurinë tuaj fizike ose sigurinë e fëmijëve?
a) Po
b) Jo
10. Përzgjedhjen e kujdestarisë kush e realizon?
a) Unë personalisht
b) Gjykata
c) Nuk kam qenë e kyqur në këtë rast.

Rezultatet e hulumtimit janë të paraqitura në tabela dhe grafikone

Tabela 1.

Numri i përgjithshëm i të anketuarëve është 150, prej të cilëve 90 janë meshkuj ndërsa 60 janë femra.

Numri i përgjithshëm i të anketuarëve	150
Meshkuj	90
Femra	60



Grafikoni 1.


Gjithësej 150 të anketuar, meshkuj 60%, femra 45%. Në grafikonin e parë janë paraqitur në përqindje numri i pjesëmarrësve në anketë në bazë të gjinisë.

Tabela 2.

Në tabelën e dytë kemi paraqitur kategorinë në grupmoshat të pjesëmarrësve në anketë.

Grup mosha e të anketuarëve	Numri i pjesëmarrësve
Nga 20 deri 25	30
Nga 26 deri 30	40
Nga 31 deri 39	36
Nga 40 deri 50	44

Grafikoni 2.



Në grafikonin e dytë shihet qartë në përqindje moshë e pjesëmarrësve në anketë, këtu mund të dallojmë se përqindja më e madhë është tek moshë 26-30 me 27%, kurse përqindja më e vogël e të të anketuarëve është grup moshë 20-25 me 20%.

Tabela 3.

Tabela e tretë përfshinë nivelin e shkollimit të të anketuarëve, nga pjesëmarrësit në hulumtim del se të anketuarit në numrë më të madh ishin me shkollim të mesëm, ndërsa me përqindje më të vogël ishin me shkollim fillorë.

Niveli i shkollimit	Kategoritë e të anketuarëve
Me shkollim fillor	20
Me shkollim të mesëm	69
Me shkollim të lartë	61

Grafikoni 3.




Tabela 4.

Në tabelën e katërt janë paraqitur vendbanimi i të anketuarëve.

Vendbanimi i të anketuarëve	Numri i të anketuarëve në qytetin përkatës
Rajoni i Dibrës	150

Grafikoni 4.



Shpërndarja e anketës është realizuar në qytetin e Dibrës.

Pyetjet e anketës janë gjithësej 14, në vazhdim do të paraqes secilën pyetje me përqindje në grafikone dhe tabela dhe do të shqyrtojmë mundësitë e parashtruar për përgjigje.

5. A jeni aktualisht e martuar ose bashkëjetoni me një burrë/ grua?

Tabela 5.

Mundësia për tu përgjigjur	Numri i përgjigjeve
a) Po, aktualisht e martuar	80
b) Po, bashkëjetojë me një burrë/ grua	50
c) Jo nuk jam në asnjë lidhje	30

Grafikoni 5.




Në pyetjen e parëqështë realizuar me të anketuarit në rajonin e Dibrës, respondentët janë përgjigjur se 61% e tyre bashkëjetojë, 1% e të anketuarëve nuk ka asnjë lidhje dhe 38% janë aktualisht të martuar.

6. Cili është statusi juaj martesor?

Tabela 6.

Mundësi për tu përgjigjur	Numri i përgjigjeve
I / E martuar	70
Shkurorëzuar	70
Beqar/ Beqare	10

Grafikoni 6.



Statusi martesor i qytetarëve të anketuar në rajonin e Dibrës vijon me këto rezultate, nga 150 të intervistuar, 50% e tyre janë të martuar, 49 % prej tyre janë tëshkurorëzuar kurse vetëm 1 % i të anketuarëve ka rezultuar beqar/ beqare.

7. Cila është arsyeja kryesore e shkurorëzimit në rajonin e Dibrës?

Tabela 7.

Numri i përgjigjeve	Mundësi për tu përgjigjur
Probleme financiare	50
Dhunë	50
Tradhëti	50

Grafiku 7.



Në vitet e fundit koncepti i familjes, por edhe vetë familja shqiptare është duke kaluar një krizë të madhe. Një krizë, e cila ia ka ndryshuar përgjithmonë fytyrën familjes tradicionale shqiptare. E kaluar është tashmë familja me gjysh, gjyshe, kushërinj e kushërira. Tashmë familja

përbëhet vetëm nga prindërit dhe fëmijët. E kaluar është tashmë familja ku autoriteti i prindit ishte i padiskutueshëm. Familja, e cila dikur ishte e shenjtë, për të cilën kanë dalë aq shumë proverba prej popullit, sot nuk ngjan më me të vjetrën. Shndërrimi i shoqërisë, nga një shoqëri tradicionale dhe e mbyllur në një shoqëri të hapur kapitaliste, si dhe ndryshimet rrënjësore sociale e ekonomike, që ishin përfundim i këtij kalimi, krijuan një model të ri të familjes, i cili nuk ngjan pothuajse në asgjë me vite më përpara. Rritja e shkurorëzimeve, zvogëlimi i lindjeve, bashkëjetesa pa kurorë, krijimi i lidhjeve të paqëndrueshme e që më shpejt përfundojnë se sa fillojnë, familjet dhe modeli i funksionimit të tyre në kushtet e emigracionit, janë disa nga karakteristikat kryesore të krizës që vihen re në familjen e sotme shqiptare. Cilat janë fenomenet bazë që shprehin në trajtën më të plotë të krizës në familjen e sotme:

- Shtimi në numër i shkurorëzimeve dhe prishjes së familjeve

- Konflikti i hapur ndërmjet prindërve e fëmijëve

- Shtimi i familjeve që kanë një kryefamiljar

- Rritja e numrit të personave, kryesisht të rinjve, që bashkëjetojnë pa vënë kurorë

- Martesat që kryhen mbi bazën e interesit ekonomik dhe jo lidhjes shpirtërore

- Zvogëlimi i numrit të fëmijëve për familje

- Mungesa e mirëqenies, papunësia dhe pamundësia e mbajtjes së një familjeje. Për këtë shkak edhe të anketuarit tanë e kanë vlerësuar se Problemet Financiare janë shumë eminente dhe ndikojnë në shkurorëzim. Jeta familjare nuk është gjithmonë një idil, jetë paqësore. Bashkëjetesa me njerëz të tjerë sjell mundësi konflikti. Kohëve të fundit raportimet për “dhunën në familje” janë në rritje. A ka përnjëherë, më shumë dhunë në mes njerëzve të cilët janë të afërt me njëri tjetrin? Jo. Dhunë në marrëdhënie partneritete dhe në familje kishte gjithmonë. Strehimoret e grave dhe qendrat këshilluese tregojnë për këtë prej kohësh. Por tani edhe publiku i gjerë e sheh këtë gjithnjë e më shumë. Mendimi shoqëror ka ndryshuar. Dhuna që ndodhë brenda katër mureve nuk shihet më si një çështje personale midis dy njerëzve. Ajo konsiderohet si një çështje publike që nuk tolerohet më. Mbrojtja nga dhuna është një e drejtë themelore e njeriut që vlen, gjithashtu

edhe në shtëpi. Qeveria dhe policia dëshiron të sigurojë këtë mbrojtje. 33% e të anketuarit e kanë paraqitur dhunën shkak për ndarje midis bashkëshortëve. Tradhëtia është ajo që shumë çifte duken se i tremben më shumë gjatë bashkëjetesës së tyre. Është ana më e errët e një raporti dashurie, duke pasur dhembje, zhgënjime, vuajtje të madhe shpirtërore, frikë të vazhdueshme, humbje besimi, zemërim dhe ankth. Thuhet se ajo ndodh pikërisht atëherë kur ti nuk e pret një gjë të tillë, cilësuar gjithnjë si një mashtrim perfekt, e me shumë raste pasohet nga brerje ndërgjegje duke vjedhur buzëqeshjen në mënyrën më të padrejtë të mundshme. Kur ndodh tradhëtia flitet për një marrëdhënie jo të mirë bashkëshortore, komunikim i dërrmuar, një krizë e gjatë midis dy palëve.

Arsyet e tradhtisë janë dhe shumë të ndryshme nga çifti në çift.

- *Mosmarrëveshjet me njëri-tjetrin.*
- *Kur humb pasioni dhe aktiviteti seksual midis tyre.*
- *Kur fillon mosha e mesme – njerëzit shpesh ndiejnë nevojën për t'u dëshmuar se akoma "vlejnë".*
- *Një çift edhe pse duket se ka një raport të mirë e pozitiv, shpesh herë ndihet se i mungon dëshira për të provuar ndjesi të reja, për të thyer monotonë mbizotëruese.*
- *Ndikimi i shoqërisë apo i kolegëve të punës duke rënë pre e provokimeve.*
- *Mosvlerësimi i partnerit që bashkëjeton, shtyn drejt eksperiencave të reja.*
- *Kultivimi që ka personi për idenë e dashurisë, besnikërisë, martesës etj, ndikon në marrjen e vendimeve apo veprimeve të tij në lidhje me tradhëtinë.*
- *Nga konsumimi i martesës nuk mbetet plotësisht i kënaqur, shkon dhe e kërkon diku tjetër.*
- *Lindja e një pasioni apo dashurie të fortë për dikë tjetër. 34 % nga rajoni i Dibrës kanë deklaruar se edhe tradhëtia mund të jetë shkak i ndarjeve të shumta që ndëgjojnë.*

8. Kur çiftet vendosin që të ndahen, si e konsiderojnë çështjen e fëmijëve?

Tabela 8.

Mundësi për tu përgjigjur	Numri i përgjigjeve
Kujdestari	70
Mbështetje fëmijërore	10
Adoptim	70

Grafiku 8.




Kujdestaria e fëmijës në rast shkurorëzimi para së gjithash i takon nënës së tij. Por, nëse nëna martohet e drejta i kalon nënës së nënës (gjyshja nga nëna), nëse nuk ka, i kalon nënës së babait. 47 % e të anketuarëve kanë deklaruar se përzgjedhja më e mirë do të ishte kujdestaria kurse vetëm 46% prej tyre kanë përzgjedhur idenë për adoptim kurse vetëm 1 përqind e të anketuarëve e kanë hedhur poshtë mbështetjen fëmijërore si opsion për përzgjedhje pas shkurorëzimit.

9. Kush më së shumti vuan pas shkurorëzimit?

Tabela 9.

Mundësi për tu përgjigjur	Numri i përgjigjeve
Burri	50
Gruaja	50
Fëmijët	50

Grafiku 9




Në bazë të këtij grafikoni mund të kutpojmë se përqindjet janë shumë të përafërta vuajtjen e shkurorëzimit e realizojnë të tre palët njëjtë.

10. Çfar efekti ka shkurorëzimi tek fëmijët?

Tabela 10.

Mundësi për tu përgjigjur	Numri i përgjigjeve
Hyrje në krim	70
Bëhen të pavarur	20
Fillojnë me duhanpirjen	10
Aftësi të dobëta sociale	50

Grafiku 10.




Të anketuarit janë përgjigjur në këtë mënyre shumica e tyre mendojnë se pas shkurorëzimit fëmijët do të ndjehen në mënyrë shumë të papërshtatshme, dhe ser 59% e të ankete kanë përzgjedhur se fëmijët e ndare janë të rezikuar për hyrje në krim, kurse vetem me 23% bëhen të panvarur, kurse 10% e të anketuarëve kanë thënë se do fillojnë me duhan pirjen edhe pse ky fenomen nuk më duket shumë i prekshëm se shumicia e të rinjëve vetëm se e kanë duhan pirjen si hobi, me 8% e të anketuarëve kanë deklaruar se fëmijët e ndarë do të kenë aftësi të dobta sociale.

11. Bashkëshorti juaj, a u ndihmon financiarisht me të holla për fëmijën?

Tabela 11.

Mundësi për tu përgjigjur	Numri i përgjigjeve
Po, më ndihmon	50
Jo, nuk më ndihmon	50
Ndonjë muaj kemi problem financiare	50

Grafiku 11.



33% e të anketuarëve janë përgjigjur se sa kanë dëgjuar raste apo kanë qenë vet pjesëtarë të këtij problemi kanë thënë se kanë pasur probleme gjatë pages mujorshe për fëmijët, kurse 33% i radhës kanë thënë se nuk u ndihmon bashkëshorti për ndihmën financiare, kurse 34% kanë thënë se nuk e kanë ndihmën e bashkëshortit.

12.A ka ndodhur ndonjë rast, kur bashkëshorti juaj u ka kërcnuar juve, ose fëmijëve tuaj për dëmtim

Tabela 12.

Mundësi për tu përgjigjur	Numri i përgjigjeve
PO	80
JO	10
Ndonjëherë	60

Grafiku 12.




Me përgjigjen Po janë përgjigjur rreth 53% e të anketuarve të cilët kanë deklaruar se kanë qenë të kërcnuar për dëmtim tek fëmijët, me 7% kanë deklaruar se nuk kanë qenët kërcnuar, kurse vetëm 40% e të anketuarëve kanë deklaruar se ndonjëherë kanë qenë të kërcnuar për dëmtim për fëmijët ose ato.

13.A jeni shqetësuar për e sigurinë tuaj fizike ose sigurinë e fëmijëve?

Tabela 13.

Mundësi për tu përgjigjur	Numri i përgjigjeve
Po	100
Jo	50

Grafiku 13.



Nga të anketuarit janë deklaruar se 67% e të anketuarve kanë thënë se janë shumë të shqetësuar për sigurinë fizike ose sigurinë e fëmijëve, kurse 33% e të anketuarve janë deklaruar se nuk kanë frigë nga puna fizike.

14. Përzgjedhjen e kujdestarisë kush e realizon?

Tabela 14.

Mundësi për tu përgjigjur	Numri i përgjigjeve
Unë personalisht	20
Gjykata	110
Nuk kam qenë e kyqur në këtë rast	20

Grafiku 14.



Përzgjedhjen e kujdestarisë 84% e të anketuarve janë përgjigjur se e përcakton gjykata, kurse 15% e të anketuarve kanë thënë se personalisht e përcaktojnë, kurse vetëm 1% kanë deklaruar se nuk kanë qenë të kyqur.

KAPITULLI I KATËRT
PERFUNDIME DHE REKOMANDIME

1. Përfundimi

Shkurorëzimi është një problem sa juridik aq edhe social dhe kryesisht shkaktohet, kur ndërmjet dy partnerëve është thyer ndjenja, intimiteti, komunikimi dhe padyshim që marrëdhënia nuk funksionon më, duke përfshirë në një stres të përgjithshëm të gjithë anëtarët. Shkurorëzimi është një situatë tepër stresuese për të gjithë pjesëtarët e familjes që e përjetojnë atë dhe paraqitet si një ndryshim madhor në jetën e individit, të cilit i nevojitet një kohë e konsiderueshme për t'u rikuperuar e adaptuar me të. Shkurorëzimi në R. Maqedonisë është tregues i zhvillimit të shoqërise, por edhe i problemeve të saja të shumta. Nga shqyrtimi dhe analizimi i institutit të shkurorëzimit dhe në vecanti i pasojave juridike që lindin rezulton se shoqëria jonë ende nuk është zhvilluar deri në atë shkallë ku shkurorëzimi të zhvillohet si proces jetësor pa pasur crregullime dhe pasoja tek të prekurit në të.

Përmes këtij punimi jam munduar të paraqes mënyrat dhe shkaqet e shkurorëzimit, të parapara sipas Ligjit për Familjen të R.M-së, përparsitë dhe mangesitë e tyre gjatë zbatimit praktik, seancën për pajtimin e bashkëshortëve dhe mundësinë e zëvendësimit të saj me mërmjetësimin familjar si mënyrë bashkëkohore e zgjidhjes jokonfliktuale të mosmrveshjeve familjare, sidomos ato mes bashkëshortëve.

Nga shqyrtimi dhe analizimi i institutit të shkurorëzimit dhe në vecanti i pasojave që rrjedhin nga ai, rezulton se; vihet re cënimi i të drejtave të fëmijëve në detyrimin ushqimor, kontaktet (vizitat) dhe mosdhënia e pëlqimit për lëshimin e dokumentave e dhënie të lejes për udhëtim. E drejta në ushqimi dhe ajo për kontaktimin e fëmijëve, të cilët jetojnë të ndarë nga prindërit e tyre apo vetëm me njërin prind, ka për qëllim mbrojtjen e shëndetit dhe të mirëqenies së tyre. Përkundër detyrimit ligjor të prindërve, për t'iu siguruar fëmijëve të tyre kushte normale për jetesë, duke iu paguar ushqimin, në disa raste vihet re se ata i shmangen këtij detyrimi. Në rastin e divorcit, në më të shumtën e rasteve, fëmijët e mitur iu besohen për ruajtje, kujdes dhe edukim nënave dhe më pak baballarëve. Nga rastet praktike gjyqësore, të analizuar në këtë studim, shihet se numri i prindërve, që detyrohen të paguajnë ushqimin për fëmijët e tyre është i vogël dhe kur kësaj i shtojmë edhe faktin se nga ky numër i vogël, disa prindër i shmangen përsëri pagesës së ushqimit, duket qartë se kështu rrezikohet shëndeti dhe mirëqenia e fëmijëve. Ashtu sikurse iu cenohet e drejta e ushqyerjes, fëmijëve u cenohet edhe e drejta e kontaktit (e

vizitës), por në këto raste kjo ndodh nga ana e prindit, të cilit i është besuar fëmija për përkujdesje . Edhe pse rastet e mosdhënies së pëlqimit nga ana e prindit për nxjerrjen e dokumenteve të udhëtimit apo të daljes së fëmijës jashtë vendit janë në numër më të vogël, ato flasin për cenimin e të drejtës së fëmijës për lëvizjen e lirë. Nga rastet e analizuara rrjedh se këto veprime të prindërve ndaj fëmijëve ndodhin kryesisht për shkak të keqësimit të raporteve bashkëshortore.

Gjithashtu në proceset e shkurorëzimit mund të vërehet se çështja e barazisë gjinore paraqet një sfidë për shoqërinë tonë, ashtu edhe për gratë, të cilat përballen me rastet e realizimit të të drejtave të tyre ligjore lidhur me trashëgiminë dhe pasurinë, rastet e perpjestimit të pasurisë. Pasuria e përbashkët paraqet një sfidë me të cilën ballafaqohen bashkëshortët në rastin e realizimit të kësaj të drejte ligjore. Institucionet, shoqëria civile dhe gjykatat, në të ardhmen, duhet të kontribuojnë në drejtim të realizimit të të drejtave pasurore të bashkëshortes. Çështja që duhet shtruar lidhur me pjesëtimin e pasurisë së përbashkët, është mohimi, si edhe paraqitja e pengesave në pjesëtimin e kësaj pasurie, kryesisht, nga ana e bashkëshortëve burra kundër grave.

Procedura gjyqësore për shkurorëzim të martesës duke u nisur nga ajo se trajtohet lëndë delicate dhe sentimentale duhet të zhvillohet në afat kohor mjaft të arsyeshëm duke u nisur nga rrethanat e secilit rast në vecanti , pra rekomandojmë të ketë efikasitet dhe respektim të afateve ligjore që procedura mos strëzgjatet .

Mund të arrijmë në përfundim se sfera ligjore që i rregullon marrëdhëniet familjarë dhe martesore në Republikën e Maqedonisë është mjaft e gjerë. Ligji për Familjen si dhe Ligji për Procedurë Jokontestimore në mënyrë të detajuar trajton, sqaron dhe rregullon çështjet juridiko-shoqërore mes bashkëshortëve të drejtat dhe detyrimet të dalin nga këto raporte dhe mbrojtjen e tyre, mirëpo përsëri hasim në magësi të cilat rekomandojmë të shyrtohen dhe të krijohen grupe punuese të cilat do të mundohen të inkorporojnë standartet evropjanë duke i përshatur ato me kushtet ku jeton shoqëria jonë.

Biblografia

Tekste, monografi, artikuj

1. Abdulla Aliu Mr.sc Haxhi Gashi “E Drejta Familjare” Ligjerata te autorizuar
2. Faik Brestovci “E Drejta Procedurale Civile” Prishtine 2002
3. Gani Oruci “E drejta Famijare” ligjerata te autorizuar Prishtine 1994
4. Ruzhdi Berisha Doracaku per peergaditjen e provimit te jurispodenes, Prishtine 2004
5. Valentine Zace “Marrëdhëniet martesore sipas legjislacionit shqipëtar”, Tirane 1999
6. Ackerman, M.J., & Ackerman, M.C. (1997). Custody evaluation practice: A survey of experienced professionals (revisited). Professional Psychology: Research and Practice
7. Balili Arta Mandro, Meçaj Vjollca, Zaka Tefta, Fullani Arjana, Edrejta familjare, Tiranë, 2006
8. Mira Alincic, Ana Bakarovic, Dubravka Hrabar, Dijana Jakovac Lozic, Aleksandra Korac “Obiteljsko Pravo” Zagreb 2001
9. Adler, P., A., & Adler, P. (2011) The tender cut: Inside the hidden world of Self-Injury. NewYork: NewYork university press
10. Drashkic Marija, Dali semejnoto pravo e gragjansko pravo, Godishnik na pravniot fakultet, Skopje,2006
11. Drashkic Marija, Porodicno pravo i prava deteta, Beograd, 2005
12. Halimi Musli, Lex duodecim tabularum, Marëdhëniet juridike që i rregullon Ligji i XII tabelave, Tetovë, 2004
13. Trpenovska-Spirovic, Lilana, Semejno pravo, Skopje,1997
14. Puhani, Ivo, E drejta romake,Prishtinë 1971
15. Kiril Cavdar, komentar na Zakonot za semejstvo, Shkup 1988
16. Makedon Sllavkoski, Puna në zyrë për vitin III lëndë zgjedhore dhe e rregulltë, drejtimi ekonomik – juridik dhe tregtar, teknik juridik, Shkup, 2013, fq.57Adolescents after divorce – Christy M. Buchanan, Cambridge, 1996
17. Zenaid Xhelmo, Hyrje në Drejtësi, Sarajevë/Prishtinë, 2006, fq.

18. Alinivic, Mira-Bakaric Abrahamovic, Ana-Hrabar, Dubravka- Jakovac Lozic, Dijana-Korac Aleksandra, Obiteljsko pravo, Narodne novine, Zagreb, 2001
19. *Rekomandim i Këshillit të ministrave të Këshillit të Evropës nr.R (98)* për ndërmjetësimin, gjendet edhe në <https://wcd.coe.int/com.instranet.InstraServlet?command=com.instranet.CmdBlobGet&InstranetImage=1153972&SecMode=1&DocId=450792&Usage=2>.
20. Nga analiza e kërkesave për shkurorëzim të paraqitura pranë gjykatës, akteve ndimeve të sjella nga ana e gjykatës si dhe intervista e realizuar me kryetarin e gjykatës Mersim Marku /Diber 2017
21. Avramovic Sima, Stanimirovic Vojislav, Uporesna Pravna Tradicija, Beograd, 2008
22. Babic Ilija, Porodicno pravo, Beograd, 1999
23. <http://www.dedeslaw.gr/article/publications/articles/civil-criminal-laë-procedure/kujdestaria-e-femijeve-pas-divorcit-kush-dhe-si-e-merr/615>

Akte ligjore, Konventa, Direktiva

- Ligji për Familjen në Republikën e Maqedonisë (e parashtruar në Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë, Nr.153 nga 20-10-20014), <http://ëëë.pravdiko.mk/zakon-za-semejstvoto/>
- Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë, Nr.08-4642/1, 17 Nëntor 1991
- Ligji për procedurën kontestimore, Gazeta zyrtare nr.79/05, neni 46, aliena 1 dhe 2
- Ligji për trashëgimi, Gazeta zyrtare nr.47/96

Burime nga interneti

- <http://psikologji.net/forumi/index.php?topic=14.0>
- <http://ëëë.lidhjahoxhallareve.com/l/kujdestaria-e-femijes-ne-rast-divorci/>
- <http://isld-ks.com/ëp/ëp-content/uploads/2015/09/Jeta-Shkurti-Sfidat-e-prind%C3%ABrimit-pas-divorcit1.pdf>
- <http://ëëë.stat.gov.mk/pdf/2017/2.1.17.13.pdf>
- Të dhënat janë marrë nga Enti Shtetëror Statistikor i RM-së, Shkup, 16.06.2009, Nr. 2.1.9.17